

---

**RREGULLORE (BE) NR. 514/2014 E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT, DATË 16 PRILL 2014, "PËR PËRCAKTIMIN E DISPOZITAVE TË PËRGJITHSHME PËR FONDIN E AZILIT, MIGRACIONIT DHE INTEGRIMIT DHE PËR INSTRUMENTIN PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE PËR BASHKËPUNIMIN POLICOR, PARANDALIMIN DHE LUFTËN NDAJ KRIMIT DHE MENAXHIMIN E KRIZËS"**

PARLAMENTI EVROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Funkcionimin e Bashkimit Evropian dhe, në veçanti, nenin 78, paragrafi 2, nenin 79, paragrafi 2 dhe 4, nenin 82, paragrafi 1, neni 84 dhe neni 87, paragrafi 2 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit Evropian,

Pas komunikimit të projektaktit legjislativ në parlamentet kombëtare,

Duke pasur parasysh opinionin e Komitetit Evropian Ekonomik dhe Social<sup>1</sup>,

Duke pasur parasysh opinionin e Komitetit të Rajoneve<sup>2</sup>,

Duke vepruar në përputhje me procedurën e zakonshme legjislative<sup>3</sup>,

Meqë:

1. Politika e punëve të brendshme të BE-së është krijimi i një hapësire të lirisë, sigurisë dhe drejtësisë: një zonë pa kufij të brendshëm ku njerëzit mund të hyjnë, lëvizin, jetojnë dhe punojnë lirisht, të bindur që të drejtat e tyre respektohen plotësisht dhe siguria e tyre garantohet, duke mbajtur parasysh sfidat e përbashkëta të tilla si zhvillimi i një politike gjithëpërfshirëse për imigracionin për të rritur konkurrueshmërinë dhe kohezionin social të BE-së, krijimi i një sistemi të përbashkët evropian për azilin, parandalimi i kërcënimeve të veprimtarive kriminale të rënda dhe krimit të organizuar dhe lufta kundër emigracionit të paligjshëm, trafikimit të qenieve njerëzore, krimit kibernetik dhe terrorizmit.

2. Është e domosdoshme që të miratohet një qasje e integruar ndaj pyetjeve që lindin nga presioni i aplikimeve për migracion dhe azil dhe lidhur me menaxhimin e kufijve të jashtëm të BE-së, duke siguruar respektim të plotë të së drejtës ndërkombëtare dhe të drejtave të njeriut, përfshirë edhe veprimet e zbatuara në vendet e treta, duke treguar solidaritet midis të gjitha shteteve anëtare dhe duke shfaqur një ndërgjegjësim për nevojën e respektimit të përgjegjësiave kombëtare në procesin e garantimit të një përkufizimi të qartë të detyrave.

3. Financimi i BE-së për të mbështetur zhvillimin e zonës së lirisë, sigurisë dhe drejtësisë duhet të sjellë vlerë të shtuar për BE-në dhe të përbëjë një shenjë të prekshme të solidaritetit dhe ndarjes së përgjegjësiave, të cilat janë të domosdoshme për t'iu përgjigjur sfidave të përbashkëta.

4. Ekzistenca e një kuadri të përbashkët duhet të sigurojë koherencën e nevojshme, thjeshtëzimin dhe zbatimin uniform të atij financimi në të gjitha fushat e politikave përkatëse.

5. Shpenzimet e fondeve në atë fushë duhet të koordinohen për të siguruar plotësim, efikasitet dhe vizibilitet, si dhe për të arritur sinergji buxhetore.

6. Një kuadër i përbashkët duhet të përcaktojë parimet e ndihmës dhe të identifikojë përgjegjësitë e shteteve anëtare dhe të Komisionit për të siguruar zbatimin e këtyre parimeve, duke përfshirë parandalimin dhe zbulimin e parregullsive dhe mashtrimeve.

7. Një financimi i tillë nga BE do të ishte më efikas dhe më i mirëorientuar nëse bashkëfinancimi i veprimeve të kualifikuara do të bazohej në programimin strategjik shumëvjeçar, të hartuar nga secili shtet anëtar gjatë dialogut me Komisionin.

8. Masat në dhe në lidhje me vendet e treta të mbështetura përmes rregulloreve specifike që përcaktohen në këtë rregullore ("Rregulloret Specifike") duhet të merren në sinergji dhe në koherencë me veprime të tjera jashtë BE-së të mbështetura nëpërmjet instrumenteve të ndihmës së jashtme të BE-së, si gjeografike ashtu edhe tematike. Në veçanti, në zbatimin e veprimeve të tilla, duhet të kërkohet koherenca e plotë me parimet dhe objektivat e përgjithshme të veprimit të jashtëm të BE-së dhe të politikës së jashtme në lidhje me vendin ose rajonin në fjalë. Këto masa nuk duhet të synojnë të mbështesin veprimet që orientohen drejtpërdrejtë drejt zhvillimit dhe duhet të plotësojnë, kur është e përshtatshme, ndihmën financiare të ofruar nëpërmjet instrumenteve të ndihmës së jashtme. Duhet të respektohet parimi i koherencës së politikave për zhvillim, siç përcaktohet në paragrafin 35 të konsensusit evropian për zhvillim. Gjithashtu është e rëndësishme të sigurohet se zbatimi i ndihmës emergjente është në përputhje me dhe, kur është e përshtatshme, plotësuese për politikën humanitare të BE-së dhe respekton parimet humanitare, siç përcaktohet në Konsensusin Evropian për Ndihmën Humanitare.

9. Veprimi i jashtëm duhet të jetë i qëndrueshëm dhe koherent, siç përcaktohet në nenin 18, paragrafi 4 të Traktatit për Bashkimin Evropian (TBE).

10. Para përgatitjes së programeve shumëvjeçare, si një mjet për arritjen e objektivave të një financimi të tillë nga BE, shtetet anëtare dhe Komisioni duhet të angazhohen në një dialog politik dhe në këtë mënyrë të krijojnë një strategji koherente për çdo shtet anëtar individual. Pas përfundimit të dialogut politik, çdo shtet anëtar duhet t'i paraqesë Komisionit një program kombëtar ku përshkruan se si synon të arrijë objektivat e rregullores specifike përkatëse për periudhën 2014-20. Komisioni duhet të shqyrtojë nëse programi kombëtar është në përputhje me ato objektiva dhe me rezultatin e dialogut politik. Për më tepër, Komisioni duhet të shqyrtojë nëse shpërndarja e fondeve të BE-së midis objektivave është në përputhje me përqindjen minimale të përcaktuar për objektiv në rregulloren specifike përkatëse. Shtetet anëtare duhet të kenë mundësi të devijojnë nga ato përqindje minimale, dhe në këtë rast duhet të japin arsyet për devijimin në programin e tyre kombëtar. Në rast se arsyet e dhëna nga shteti anëtar në fjalë nuk konsiderohen të përshtatshme, Komisioni mund të mos e miratojë programin kombëtar. Komisioni duhet të informojë Parlamentin Evropian rregullisht për rezultatet e dialogut politik, për procesin e plotë të programimit duke përfshirë përgatitjen e programeve kombëtare, duke mbuluar gjithashtu edhe pajtueshmërinë me përqindjen minimale të përcaktuar për objektiv në

rregulloret specifike përkatëse të përcaktuara në këtë rregullore dhe zbatimin e programeve kombëtare.

11. Strategjia duhet t'i nënshtrohet një rishikimi afatmesëm, për të siguruar fondet e duhura në periudhën 2018-20.

12. Shtetet anëtare duhet të krijojnë, në një mënyrë të pajtueshme me parimin e proporcionalitetit dhe me nevojën për të minimizuar barrën administrative, një partneritet me autoritetet dhe organet përkatëse për të zhvilluar dhe zbatuar programet e tyre kombëtare gjatë gjithë periudhës shumëvjeçare. Shtetet anëtare duhet të garantojnë se nuk ka konflikt interesi ndërmjet partnerëve në fazat e ndryshme të ciklit të programimit. Secili shtet anëtar duhet të krijojë një komision për të monitoruar programin kombëtar dhe ta ndihmojë atë në rishikimin e zbatimit dhe të progresit të bërë në arritjen e objektivave të programit. Secili shtet anëtar duhet të jetë përgjegjës për përcaktimin e masave praktike për themelimin e komitetit të monitorimit.

13. Kualifikimi i shpenzimeve në zbatim të programeve kombëtare duhet të përcaktohet nga legjislacioni i brendshëm, në përputhje me parimet e përbashkëta të përcaktuara në këtë rregullore. Datat e fillimit dhe të mbylljes për kualifikimin e shpenzimeve duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që garanton rregulla të njëtrajtshme dhe të barabarta që zbatohen për programet kombëtare.

14. Asistenca teknike duhet t'u mundësojë shteteve anëtare që të mbështesin zbatimin e programeve të tyre kombëtare dhe t'i ndihmojnë përfituesit që të veprojnë në pajtim me detyrimet e tyre dhe me legjislacionin e BE. Sipas rastit, asistenca teknike mund të mbulojë kostot e shkaktuara nga autoritetet kompetente në vendet e treta.

15. Për të siguruar një kuadër të përshtatshëm për dhënien e shpejtë të ndihmës emergjente, kjo rregullore duhet të lejojë mbështetjen për veprimet, shpenzimet e të cilave janë bërë përpara se të bëhet aplikimi për një ndihmë të tillë, por jo më parë se 1 janari 2014, në përputhje me dispozitën e Rregullores (BE, Euratom) nr. 966/2012 së Parlamentit Evropian dhe Këshillit<sup>4</sup>, e cila lejon një fleksibilitet të tillë në raste të jashtëzakonshme të justifikuara në mënyrë të duhur. Mbështetja mund të përbëjë 100% të shpenzimeve të kualifikuara në raste plotësisht të justifikuara kur kjo është thelbësore për kryerjen e veprimit, veçanërisht kur përfituesi është një organizatë ndërkombëtare ose joqeveritare. Veprimet e mbështetura me ndihmën emergjente duhet të marrin shkas drejtpërdrejt nga situata emergjente dhe nuk duhet të zëvendësojnë investimet afatgjata nga shtetet anëtare.

16. Vendimet e marra në lidhje me kontributin nga buxheti i BE-së duhet të dokumentohen si duhet për të ruajtur një gjurmë të përshtatshme auditi.

17. Interesat financiare të BE-së duhet të mbrohen me anë të masave proporcionale gjatë ciklit të shpenzimit, duke përfshirë parandalimin, zbulimin dhe hetimin e parregullsive, rikuperimin e fondeve të humbura, të atyre që janë paguar gabimisht ose që nuk janë përdorur si duhet dhe, sipas rastit, edhe me anë të penaliteteve administrative dhe financiare në përputhje me rregulloren (BE, Euratom) nr. 966/2012.

18. Në kontekstin e mbrojtjes së interesave financiare të BE-së, kontrollet dhe auditet në terren, të kryera nga shtetet anëtare, Komisioni, Gjykata e Audituesve dhe Zyra Evropiane

Kundër Mashtrimit, e themeluar me Vendimin e Komisionit 1999/352/KE, KEQÇ, Euratom<sup>5</sup> ("OLAF") mund të bëhen me paralajmërim ose pa paralajmërim, në përputhje me ligjin në fuqi.

19. Struktura e re e financimit në fushën e punëve të brendshme ka për qëllim thjeshtëzimin e rregullave të zbatueshme dhe zvogëlimin e barrës administrative për përfituesit. Megjithatë, mekanizmi i kontrollit duhet të mbetet efikas dhe për këtë arsye është me rëndësi të vihen në zbatim rregullat e zbatueshme për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së, duke parashikuar kontrolle në terren dhe audite të cilat mund të bëhen me ose pa paralajmërim.

20. Shtetet anëtare duhet të marrin masa të përshtatshme për të garantuar funksionimin e duhur të sistemit të menaxhimit dhe të kontrollit dhe cilësinë e zbatimit të programeve të tyre kombëtare. Për këtë qëllim, është e nevojshme të përcaktohen parimet e përgjithshme dhe funksionet e nevojshme që këto sisteme duhet të përmbushin.

21. Detyrimet për shtetet anëtare në lidhje me sistemet e menaxhimit dhe të kontrollit dhe parandalimin, zbulimin e korrigjimin e parregullsive dhe shkeljeve të legjislacionit të BE-së duhet të specifikohen me qëllim që të garantohet zbatimi efikas dhe korrekt i programeve të tyre kombëtare.

22. Në përputhje me parimet e subsidiaritetit dhe proporcionalitetit, shtetet anëtare duhet të mbajnë përgjegjësinë kryesore, nëpërmjet sistemeve të tyre të menaxhimit dhe kontrollit, për zbatimin dhe kontrollin e programeve kombëtare. Mbështetja e dhënë sipas rregulloreve specifike duhet të zbatohet në bashkëpunim të ngushtë midis Komisionit dhe shteteve anëtare në përputhje me parimin e subsidiaritetit.

23. Shtetet anëtare duhet të shfrytëzojnë plotësisht njohuritë, ekspertizën dhe përvojën e fituar nga organet publike dhe/ose private në zbatimin e fondeve më të hershme në fushën e punëve të brendshme.

24. Vetëm autoritetet përgjegjëse të përcaktuara nga shtetet anëtare ofrojnë garanci të arsyeshme se janë kryer kontrollet e nevojshme përpara dhënies së mbështetjes për përfituesit nga buxheti i BE-së. Për këtë arsye, duhet të përcaktohet në mënyrë të qartë se vetëm shpenzimet e kryera nga autoritetet përgjegjëse të përcaktuara mund të rimbursohen nga buxheti i BE-së.

25. Duhet të përcaktohen kompetencat dhe përgjegjësitë e Komisionit për të verifikuar funksionimin e efektshëm të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit dhe për të kërkuar veprimet e shteteve anëtare.

26. Angazhimet buxhetore të BE-së duhet të ekzekutohen çdo vit. Për të siguruar një menaxhim efektiv të programeve, duhet të përcaktohen rregullat e përbashkëta për pagesën e bilancit vjetor dhe bilancit përfundimtar.

27. Pagesa e financimit paraprak në fillim të programeve garanton që shtetet anëtare kanë mjetet për të siguruar mbështetje për përfituesit në zbatimin e programit sapo ky i fundit të miratohet. Prandaj, duhet të parashikohen shumat fillestare të financimit paraprak. Financimi paraprak duhet të jetë likuiduar plotësisht në mbyllje të programit. Autoritetet përgjegjëse duhet të sigurojnë që përfituesit të marrin shumën e plotë menjëherë.

28. Përveç kësaj, duhet të sigurohet financimi paraprak vjetor për të garantuar që shtetet anëtare kanë mjete të mjaftueshme për të zbatuar programet e tyre kombëtare. Financimi paraprak vjetor duhet të likuidohet çdo vit me pagesën e bilancit vjetor.

29. Rishikimi trevjeçar i rregullores (BE, Euratom) nr. 966/2012 përfshin ndryshime të metodës së menaxhimit të përbashkët, të cilat duhet të merren parasysht.

30. Me qëllim forcimin e llogaridhënies për shpenzimet e bashkëfinancuara nga buxheti i BE-së për çdo vit, duhet të krijohet një kornizë e përshtatshme për likuidimin vjetor të llogarive. Në këtë kuadër, autoriteti përgjegjës duhet t'i paraqesë Komisionit, në lidhje me një program kombëtar, dokumentet e përmendura në dispozitat për menaxhimin e përbashkët me shtetet anëtare të Rregullores (BE, Euratom) nr. 966/2012.

31. Për të garantuar sigurinë e likuidimit vjetor të llogarive në të gjithë BE-në, duhet të përcaktohen dispozita të përbashkëta për natyrën dhe nivelin e kontroleve që duhet të kryhen nga shtetet anëtare.

32. Për të siguruar menaxhimin e shëndoshë financiar të burimeve të BE-së, mund të jetë e nevojshme që Komisioni të bëjë korrigjime financiare. Për të garantuar siguri juridike për shtetet anëtare, është e rëndësishme të përcaktohen rrethanat nën të cilat shkeljet e legjislacionit të zbatueshëm të BE-së ose të atij të brendshëm, mund të çojnë në korrigjime financiare nga Komisioni. Për të siguruar që çdo korrigjim financiar që Komisioni mund t'u imponojë shteteve anëtare është i lidhur me mbrojtjen e interesave financiare të BE-së, ato duhet të kufizohen vetëm në rastet kur shkelja e legjislacionit të BE-së ose atij të brendshëm në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ka të bëjë me përshtatshmërinë, rregullsinë, menaxhimin ose kontrollin e veprimeve dhe të shpenzimeve përkatëse. Për të garantuar proporcionalitetin, është e rëndësishme që Komisioni të marrë në konsideratë natyrën dhe peshën e shkeljes gjatë vendosjes së masës së korrigjimit financiar. Në këtë drejtim, duhet të përcaktohen kriteret për zbatimin e korrigjimeve financiare nga Komisioni dhe procedura që mund të çojë në një vendim për korrigjimin financiar.

33. Me qëllim të vendosjes së marrëdhënieve financiare ndërmjet autoriteteve përgjegjëse dhe buxhetit të BE-së, Komisioni duhet të likuideojë llogaritë e këtyre autoriteteve çdo vit. Vendimi për likuidimin e llogarive duhet të mbulojë plotësinë, saktësinë dhe vërtetësinë e llogarive, por jo përputhshmërinë e shpenzimeve me legjislacionin e BE-së.

34. Meqenëse Komisioni është përgjegjës për zbatimin e duhur të legjislacionit të BE-së sipas nenit 17 të TBE-së, ai duhet të vendosë nëse shpenzimet e kryera nga shtetet anëtare janë në përputhje me legjislacionin e BE-së. Shteteve anëtare duhet t'u jepet e drejta për të justifikuar vendimet e tyre për të kryer pagesa. Për t'iu dhënë shteteve anëtare siguri juridike dhe financiare për shpenzimet e kryera në të kaluarën, duhet të caktohet një periudhë maksimale për Komisionin që ai të vendosë se çfarë pasojash financiare vijnë nga mospërputhja.

35. Është e rëndësishme që të garantohet menaxhim financiar i shëndoshë dhe zbatim i efektshëm, duke garantuar ndërkohë transparencë, siguri juridike, aksesueshmëri në financim dhe trajtim të barabartë për përfituesit.

36. Me qëllim thjeshtësimin e përdorimit të financimit dhe zvogëlimin e rrezikut për gabime, duke siguruar diferencimin aty ku është e nevojshme për të pasqyruar specifikat e politikës, duhet të përcaktohen format e mbështetjes dhe kushtet e harmonizuara për pranueshmërinë e granteve për shpenzime, duke përfshirë opsionet e thjeshtuara të kostove. Në përputhje me parimin e subsidiaritetit, shtetet anëtare duhet të miratojnë rregulla kombëtare për përshtatshmërinë e shpenzimeve.

37. Për të nxitur disiplinën financiare, duhet të përcaktohen masat për anulimin e çdo pjese të angazhimit buxhetor në një program kombëtar, veçanërisht kur një shumë mund të përjashtohet nga anulimi i detyrimeve, sidomos kur vonesat në zbatim vijnë nga procedurat ligjore ose një ankesë administrative që ka fuqi pezulluese ose për arsye të një force madhore.

38. Për të garantuar zbatimin e duhur të rregullave të përgjithshme për anulimin, rregullat e vendosura duhet të detajojnë se si vendosen afatet për anulimin dhe si llogariten shumat përkatëse.

39. Është e rëndësishme që arritjet e financimit të BE-së të sillen në vëmendjen e publikut të gjerë. Qytetarët kanë të drejtë të dinë se si shpenzohen burimet financiare të BE-së. Përgjegjësia për të siguruar që informacioni i duhur i komunikohet publikut duhet të jetë e Komisionit, e autoriteteve përgjegjëse dhe e përfituesve. Për të siguruar efikasitet më të madh në komunikimet që i bëhen publikut të gjerë dhe sinergji më të forta midis aktiviteteve të komunikimit të ndërmarrë me nismë të Komisionit, buxheti i alokuar për aktivitetet e komunikimit sipas këtij financimi të BE-së duhet të kontribuojë gjithashtu në mbulimin e komunikimit institucional të prioritetëve të përgjithshme të BE-së, me kusht që ato të kenë lidhje me objektivat e përgjithshme të financimit të BE-së në fushën e punëve të brendshme.

40. Me qëllim sigurimin e shpërndarjes së gjerë të informacionit në lidhje me financimin e BE-së në fushën e punëve të brendshme dhe informimin e përfituesve të mundshëm rreth mundësive për financim, rregullat e detajuara në lidhje me masat e informimit dhe të komunikimit, si dhe karakteristikat e caktuara teknike të këtyre masave duhet të përcaktohen në bazë të kësaj rregulloreje dhe secili shtet anëtar duhet, së paku, të krijojë një faqe interneti ose portal me informacionin e nevojshëm. Shtetet anëtare duhet të ndërmarrin forma më të drejtpërdrejta të fushatave të komunikimit në mënyrë që të informojnë siç duhet përfituesit e mundshëm, ndër të tjera, duke organizuar evenimente të rregullta publike, të ashtuquajtura ditë informimi dhe sesione trajnimi.

41. Efektiviteti i veprimeve të mbështetura, varet gjithashtu nga vlerësimi i tyre dhe shpërndarja e rezultateve të tyre. Përgjegjësitë e shteteve anëtare dhe Komisionit në këtë drejtim dhe masat për të siguruar besueshmërinë e vlerësimit dhe cilësinë e informacionit përkatës duhet të formalizohen.

42. Për të ndryshuar dispozitat e kësaj rregulloreje për parimet e përbashkëta të përshtatshmërisë së shpenzimit, kompetenca për të miratuar aktet në përputhje me nenin 290 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFBE) duhet t'i delegohet Komisionit. Është shumë e rëndësishme që gjatë punës së tij përgatitore Komisioni të kryejë konsultimet e duhura, duke përfshirë ato në nivel ekspertësh. Gjatë përgatitjes dhe hartimit të akteve të deleguara,

Komisioni duhet të sigurojë një transmetim të njëkohshëm, në kohën dhe mënyrën e duhur, të dokumenteve përkatëse pranë Parlamentit Evropian dhe Këshillit.

43. Për zbatimin e kësaj rregulloreje, duke përfshirë përgatitjen e akteve të deleguara, Komisioni duhet të konsultohet me ekspertë nga të gjithë shtetet anëtare.

44. Për të garantuar kushte të njëtrajtshme për zbatimin e kësaj rregulloreje, kompetencat zbatuese duhet t'i delegohen Komisionit. Këto kompetenca duhet të ushtrohen në përputhje me Rregulloren (BE) nr. 182/2011 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit<sup>6</sup>.

45. Për zbatimin e akteve që përcaktojnë detyrime të përbashkëta për shtetet anëtare, në veçanti për dhënien e informacioneve për Komisionin duhet të përdoret procedura e ekzaminimit dhe për miratimin e akteve zbatuese në lidhje me format e modelit për sigurimin e informacionit për Komisionin, duke pasur parasysh natyrën e tyre tërësisht teknike, duhet të përdoret procedura këshilluese.

46. Meqenëse objektivat e kësaj rregulloreje, përkatësisht përcaktimi i dispozitave të përgjithshme për zbatimin e rregulloreve specifike, nuk mund të arrihen plotësisht nga shtetet anëtare, por, për shkak të shkallës dhe efekteve të masave, mund të arrihen më mirë në nivel Bashkimi Evropian, ky i fundit mund të miratojë masa në përputhje me parimin e subsidiaritetit, siç përcaktohet në nenin 5 të TBE-së. Në përputhje me parimin e proporcionalitetit, sipas përcaktimit në atë nen, kjo rregullore nuk shkon përtej asaj që është e nevojshme për arritjen e këtij objekti.

47. Përderisa kjo rregullore parashtron rregulla të përgjithshme të nevojshme për të mundësuar zbatimin e rregulloreve specifike të cilat parashikojnë zbatueshmërinë e saj ndaj këtyre rregulloreve specifike dhe të cilat përbëjnë akte që bazohen mbi tërësinë e legjislacionit të Shengenit në raport me vendet në të cilat këto rregulla specifike janë të zbatueshme në bazë të Protokolleve bashkëlidhur si shtojcë TBE-së dhe TFBE-së ose në bazë të marrëveshjeve përkatëse, kjo rregullore duhet të zbatohet së bashku me këto rregullore specifike. Në këtë drejtim, kjo nënkupton që kjo rregullore mund të krijojë një lidhje me dhe mund të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë në dispozitat e rregulloreve specifike që zhvillojnë tërësinë e legjislacionit të Shengenit duke ndikuar kështu në kuadrin ligjor të këtyre të fundit.

48. Në përputhje me nenin 3 të Protokollit nr. 21 "Për qëndrimin e Mbretërisë së Bashkuar dhe të Irlandës për zonën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë", bashkëlidhur si shtojcë TBE-së dhe TFBE-së, këto shtete anëtare kanë njoftuar dëshirën e tyre për të marrë pjesë në miratimin dhe zbatimin e kësaj rregulloreje.

49. Në përputhje me nenin 1 dhe 2 të Protokollit nr. 22 për qëndrimin e Danimarkës, bashkëlidhur si shtojcë TBE-së dhe TFBE-së, Danimarka nuk merr pjesë në miratimin e kësaj rregulloreje dhe nuk është e detyruar ta zbatojë atë apo të jetë objekt i zbatimit të saj.

50. Është me vend që periudha e zbatimit të kësaj rregulloreje të bashkërendohet me atë të zbatimit të Rregullores së Këshillit (BE, Euratom) nr. 1311/2013<sup>7</sup>. Për rrjedhojë, zbatimi i kësaj rregulloreje duhet të fillojë nga data 1 janar 2014.

**MIRATOJNË KËTË RREGULLORE:**

## KREU I

### DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

#### Neni 1

#### **Qëllimi dhe fusha e zbatimit**

Kjo rregullore përcakton rregullat e përgjithshme për zbatimin e rregulloreve specifike në lidhje me:

- a) financimin e shpenzimeve;
- b) partneritetin, programimin, raportimin, monitorimin dhe vlerësimin;
- c) menaxhimin dhe sistemet e kontrollit që do të vendosen nga shtetet anëtare; dhe
- d) likuidimin e llogarive.

#### Neni 2

#### **Përkufizime**

Për qëllimet e kësaj rregulloreje zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

- a) "rregullore specifike" janë
  - Rregullorja (BE) nr. 516/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit<sup>8</sup>;
  - Rregullorja (BE) nr. 513/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit<sup>9</sup>; dhe
  - çdo rregullore tjetër e cila parashikon zbatimin e kësaj rregulloreje;
- b) "programimi" është procesi i organizimit, vendimmarrjes dhe financimit në disa faza që synojnë të zbatojnë, në baza shumëvjeçare, veprimin e përbashkët të BE-së dhe shteteve anëtare për të arritur objektivat e rregulloreve specifike;
- c) "veprimi" është një projekt ose grup projektesh të përzgjedhur nga autoriteti përgjegjës i programit kombëtar në fjalë, ose nën përgjegjësinë e tij, që kontribuojnë në objektivat e përgjithshme dhe specifike të ndjekura nga rregulloret specifike;
- d) "veprim i BE-së" është një veprim ndërkombëtar ose veprim me interes të veçantë për BE-në siç përcaktohet në rregulloret specifike;
- e) "projekti" është një grup mjetesh specifike praktike të vendosura për të zbatuar të gjithë ose një pjesë të veprimit të një përfituesi të kontributit të BE-së;
- f) "ndihmë emergjente" është një projekt ose një grup projektesh që trajtojnë një situatë emergjente siç përcaktohet në rregulloret specifike;



g) "përfituesi" është marrësi i një kontributi të BE-së në kuadër të një projekti, qoftë ai një organ publik ose privat, organizatë ndërkombëtare ose Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (ICRC) ose Federata Ndërkombëtare e Shoqatave Kombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe.

## KREU II

### PARIMET E NDIHMËS

#### Neni 3

#### **Parime të përgjithshme**

1. Rregulloret specifike sigurojnë mbështetje, përmes programeve kombëtare, veprimeve të BE-së dhe ndihmës emergjente, e cila plotëson ndërhyrjen kombëtare, rajonale dhe lokale, duke ndjekur objektivat e BE-së dhe duke sjellë vlerë të shtuar për BE-në.

2. Komisioni dhe shtetet anëtare duhet të sigurojnë që mbështetja e ofruar sipas rregulloreve specifike dhe sipas shteteve anëtare të jetë në përputhje me aktivitetet, politikat dhe prioritetet përkatëse të BE-së dhe të plotësojë instrumentet e tjera të BE-së, duke marrë parasysh kontekstin specifik të secilit shtet anëtar.

3. Mbështetja e dhënë sipas rregulloreve specifike zbatohet në bashkëpunim të ngushtë midis Komisionit dhe shteteve anëtare.

4. Në përputhje me përgjegjësitë e tyre përkatëse, Komisioni dhe shtetet anëtare, së bashku me Shërbimin Evropian të Veprimit të Jashtëm ("EEAS") për veprimet në dhe në lidhje me vendet e treta, sigurojnë bashkërendim midis kësaj rregulloreje dhe rregulloreve specifike, dhe me politika, strategji dhe instrumente të tjera të rëndësishme të BE-së, duke përfshirë ato në kuadër të veprimit të jashtëm të BE-së.

5. Komisioni dhe shtetet anëtare, së bashku me EEAS-në, sigurojnë sipas rastit, që veprimet në dhe në lidhje me vendet e treta të kryhen në sinergji dhe në koherencë me veprime të tjera jashtë BE-së të mbështetura nga instrumentet e saj. Ata sigurojnë veçanërisht që këto veprime:

a) janë koherente me politikën e jashtme të BE-së, respektojnë parimin e koherencës së politikave për zhvillim dhe janë në përputhje me dokumentet strategjike të programimit për rajonin ose vendin në fjalë;

b) përqendrohen në masat që nuk orientohen drejt zhvillimit;

c) u shërbejnë interesave të politikave të brendshme të BE-së dhe janë në përputhje me aktivitetet e ndërmarra brenda tij.

6. Komisioni dhe shtetet anëtare zbatojnë parimin e menaxhimit të mirë financiar në përputhje me Rregulloren (BE, Euratom) nr. 966/2012, në veçanti në përputhje me parimet e ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit, siç parashikohet në nenin 30 të kësaj rregulloreje.

7. Komisioni dhe shtetet anëtare sigurojnë efektivitetin e mbështetjes së ofruar sipas rregulloreve specifike, duke përfshirë monitorimin, raportimin dhe vlerësimin.

8. Komisioni dhe shtetet anëtare kryejnë rolet e tyre përkatëse në lidhje me këtë rregullore dhe rregulloret speciale me qëllim zvogëlimin e barrës administrative për përfituesit, shtetet anëtare dhe Komisionin, duke marrë parasysh parimin e proporcionalitetit.

#### Neni 4

### **Përputhja me legjislacionin e BE-së dhe atë të brendshëm**

Veprimet e financuara nga rregulloret specifike përputhen me legjislacionin e zbatueshëm të BE-së dhe atë të brendshëm.

#### Neni 5

### **Mbrojtja e interesave financiare të Bashkimit Evropian**

1. Komisioni merr masat e nevojshme për të garantuar se gjatë zbatimit të masave të financuara sipas kësaj rregulloreje dhe rregulloreve specifike, interesat financiare të BE-së do të mbrohen nëpërmjet përdorimit të masave parandaluese kundër mashtrimit, korrupsionit dhe çdo veprimtarie tjetër të paligjshme nga kontrollet efektive, nëpërmjet rikuperimit të shumave të paguara gabimisht nëse konstatohen parregullsi, dhe sipas rastit, nëpërmjet penaliteteve financiare dhe administrative efikase, proporcionale dhe shtrënguese.

2. Shtetet anëtare parandalojnë, zbulojnë dhe korrigjojnë parregullsitë dhe rikuperojnë shumat e paguara padrejtësisht së bashku me çdo kamatvonesë. Ata ia njoftojnë ato Komisionit dhe e mbajnë atë të informuar për çdo progres të konsiderueshëm në procedurat administrative dhe ligjore përkatëse.

3. Kur shumat e paguara padrejtësisht ndaj një përfituesi, si rezultat i fajit ose neglizhencës nga ana e një shteti anëtar nuk mund të rikuperohen, ai shtet anëtar është përgjegjës për rimbursimin e shumave përkatëse në buxhetin e BE-së.

4. Shtetet anëtare ofrojnë parandalim efektiv kundër mashtrimit, veçanërisht për sa u përket zonave me një nivel më të lartë rreziku. Një parandalim i tillë vepron si pengesë, duke marrë parasysh përfitimet si dhe proporcionalitetin e masave.

5. Komisioni ka kompetencën të miratojë aktet e deleguara në përputhje me nenin 58 për detyrimet e shteteve anëtare të përcaktuara në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni.

6. Komisioni përcakton, nëpërmjet akteve zbatuese, shpeshtësinë e raportimit të parregullsive dhe formatin e raportimit që do të përdoret. Këto akte zbatuese miratohen në përputhje me procedurën këshillimore të përmendur në nenin 59, paragrafi 2.

7. Komisioni ose përfaqësuesit e tij dhe Gjykata e Audituesve kanë kompetenca për të ushtruar kontroll në bazë të dokumentacionit dhe në terren, mbi të gjithë përfituesit e granteve,

kontraktorët dhe nënkontraktorët që kanë marrë fonde të BE-së sipas kësaj rregulloreje dhe rregulloreve specifike.

8. OLAF-i mund të kryejë hetime, duke përfshirë kontrolle dhe inspektime në terren, në përputhje me dispozitat dhe procedurat e përcaktuara në Rregulloren (BE, Euratom) nr. 883/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit<sup>10</sup> dhe Rregullores së Këshillit (Euratom, KE) nr. 2185/96<sup>11</sup>, me qëllim që të përcaktohet nëse ka pasur mashtrime, korrupsion ose ndonjë veprimtari tjetër të jashtëligjshme që ndikon në interesat financiare të BE-së në lidhje me një marrëveshje për grante, vendim për grante ose një kontratë të financuar në përputhje me këtë rregullore dhe rregulloret specifike.

9. Pa cenuar paragrafët 1, 7 dhe 8, marrëveshjet e bashkëpunimit me vendet e treta dhe me organizatat ndërkombëtare, kontratat, marrëveshjet për grante dhe vendimet për grante që rezultojnë nga zbatimi i kësaj rregulloreje dhe rregulloreve specifike, përmbajnë dispozita të caktuara që i japin shprehimisht Komisionit, Gjykatës së Audituesve dhe OLAF-it kompetencat për të kryer këto kontrolle dhe hetime, sipas kompetencave të tyre përkatëse.

### KREU III

## KUADRI FINANCIAR PËR MASAT E BE-SË, ASISTENCËN EMERGJENTE DHE TEKNIKE

### Neni 6

#### **Kuadri i zbatimit**

1. Komisioni përcakton shumën e përgjithshme të vënë në dispozicion për veprimet e BE-së, ndihmën emergjente dhe asistencën teknike, me iniciativën e Komisionit, sipas ndarjeve vjetore të buxhetit të BE-së.

2. Komisioni miraton, nëpërmjet akteve zbatuese, programin e punës për veprimet e BE-së dhe ndihmën emergjente. Këto akte zbatuese miratohen në përputhje me procedurën e shqyrtimit të përmendur në nenin 59, paragrafi 3.

3. Për të siguruar disponueshmërinë në kohë të burimeve, Komisioni mund të miratojë veçmas një program pune për ndihmë emergjente.

4. Veprimet e BE-së, ndihma emergjente dhe asistencë teknike me iniciativë të Komisionit mund të zbatohen drejtpërdrejtë nga Komisioni apo përmes agjencive ekzekutive, ose tërthorazi, nga ente dhe persona të ndryshëm nga shtete anëtare në përputhje me nenin 60 të rregullores (BE, Euratom) nr. 966/2012.

### Neni 7

#### **Ndihma emergjente**

1. Në përgjigje të një situatë emergjente sipas përcaktimit në rregulloret specifike, Komisioni mund të vendosë të ofrojë ndihmë emergjente. Në raste të tilla, ai lajmëron Parlamentin Evropian dhe Këshillin në kohën e duhur.

2. Brenda kufijve të burimeve në dispozicion, ndihma emergjente mund të arrijë deri në 100 % të shpenzimeve të pranueshme.

3. Ndhimja emergjente mund të konsistojë në ndihmë për shtetet anëtare dhe për vende të treta, në përputhje me objektivat dhe veprimet e përcaktuara në rregulloret specifike.

4. Ndhimja emergjente mund të mbështesë shpenzimet të cilat janë bërë përpara datës së dorëzimit të aplikimit për grant apo kërkesës për ndihmë, por jo më parë se 1 janari 2014, kur është e nevojshme për zbatimin e veprimit.

5. Ndhimja emergjente mund të marrë formën e granteve që u jepen drejtpërdrejt agjencive të BE-së.

#### Neni 8

#### **Veprimet e BE-së dhe ndihma emergjente në ose në lidhje me vendet e treta**

1. Komisioni mund të vendosë të financojë veprime dhe ndihma financiare në ose në lidhje me vende të treta në përputhje me objektivat dhe veprimet e përcaktuara në rregulloret specifike.

2. Kur veprime të tilla zbatohen drejtpërsëdrejti, subjektet që lejohen të dorëzojnë aplikime për grant janë si më poshtë:

a) Shtetet anëtare;

b) vendet e treta, në raste plotësisht të justifikuar kur një grant është i nevojshëm për arritjen e objektivave të kësaj rregulloreje dhe rregulloreve specifike;

c) organet e përbashkëta të ngritura nga vende të treta dhe BE ose nga shtete anëtare;

d) organizatat ndërkombëtare, duke përfshirë organizatat rajonale, organet e OKB-së, departamentet dhe misionet, institucionet financiare ndërkombëtare dhe bankat zhvillimore e institucionet e juridiksionit ndërkombëtar për aq sa ato kontribuojnë në objektivat e rregulloreve specifike në fjalë;

e) ICRC-ja dhe Federata Ndërkombëtare e Shoqatave Kombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe;

f) organizatat joqeveritare të themeluara dhe të regjistruara në BE dhe në vendet e lidhura me zbatimin, përdorimin dhe zhvillimin e tërësisë së legjislacionit të Shengenit;

g) Agjencitë e BE-së për ndihmën emergjente.

#### Neni 9

## **Asistenca teknike me iniciativë të Komisionit**

1. Me iniciativën ose në emër të Komisionit, rregulloret specifike mund të mbështesin masat dhe aktivitetet përgatitore, monitoruese, administrative dhe të asistencës teknike, ato vlerësuese dhe kontrolluese të nevojshme për zbatimin e kësaj rregulloreje dhe rregulloreve specifike.

2. Masat dhe aktivitetet e përmendura në paragrafin 1 mund të përfshijnë:

- a) asistencën për përgatitjen e projektit dhe vlerësimin;
- b) mbështetjen për forcimin institucional dhe zhvillimin e kapacitetit administrativ për menaxhimin e efektshëm të kësaj rregulloreje dhe rregulloreve specifike;
- c) masat që lidhen me analizën, menaxhimin, monitorimin, shkëmbimin e informacionit dhe zbatimin e kësaj rregulloreje dhe rregulloreve specifike, si dhe masat në lidhje me zbatimin e sistemeve të kontrollit dhe asistencës teknike dhe administrative;
- d) vlerësimet, raportet e ekspertëve, statistikatat dhe studimet, duke përfshirë ato të një natyre të përgjithshme, në lidhje me funksionimin e rregulloreve specifike;
- e) veprimet për shpërndarjen e informacionit, mbështetjen e rrjetëzimit, kryerjen e aktiviteteve të komunikimit, ngritjen e ndërgjegjësimit dhe promovimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimin e përvojave, duke përfshirë edhe vendet e treta. Për të siguruar efikasitet më të madh në komunikimet që i bëhen publikut të gjerë dhe sinergji më të forta midis aktiviteteve të komunikimit të ndërmarra me nismë të Komisionit, buxheti i alokuar për aktivitetet e komunikimit sipas kësaj rregulloreje, kontribuon gjithashtu në mbulimin e komunikimit institucional të prioritetëve politike të BE-së, me kusht që ato të kenë lidhje me objektivat e përgjithshme të kësaj rregulloreje dhe rregulloreve specifike;
- f) instalimin, përditësimin, funksionimin dhe ndërlidhjen e sistemeve kompjuterike për menaxhim, monitorim, auditim, kontroll dhe vlerësim;
- g) hartimin e një kuadri të përbashkët për vlerësimin dhe monitorimin, si dhe një sistem treguesish, duke marrë parasysh, sipas rastit, treguesit kombëtarë;
- h) veprimet për të përmirësuar metodat e vlerësimit dhe shkëmbimin e informacionit për praktikatat e vlerësimit;
- I. konferenca, seminare dhe informacione të tjera të përbashkëta dhe masa trajnuese për zbatimin e kësaj rregulloreje dhe rregulloreve speciale për autoritetet kompetente dhe përfituesit;
- j) veprimet që lidhen me zbulimin dhe parandalimin e mashtrimit;
- k) veprimet që lidhen me auditin.

3. Këto masa dhe aktivitete të përmendura në paragrafin 1 mund të prekin kuadro financiare të mëparshme dhe të mëvonshme.

## KREU IV

### PROGRAMET KOMBËTARE

#### SEKSIONI 1

#### KUADRI I PROGRAMIMIT DHE I ZBATIMIT

##### Neni 10

#### **Programimi**

Objektivat e rregulloreve specifike ndiqen në kuadër të programit shumëvjeçar për periudhën 2014-20, duke iu nënshtruar rishikimit afatmesëm në përputhje me nenin 15.

##### Neni 11

#### **Ndërhyrja subvencionuese dhe proporcionale**

1. Shtetet anëtare dhe autoritetet e tyre kompetente, siç përcaktohet në nenin 25, janë përgjegjëse për zbatimin e programeve dhe kryerjen e detyrave të tyre sipas kësaj rregulloreje dhe rregulloreve speciale në nivelin e duhur, në përputhje me kuadrin institucional, ligjor dhe financiar të shtetit anëtar në fjalë dhe në përputhje me këtë rregullore dhe rregulloret specifike.

2. Masat për zbatimin dhe përdorimin e mbështetjes së parashikuar në rregulloret e veçanta, dhe në veçanti burimet financiare dhe administrative të kërkuara në lidhje me raportimin, vlerësimin, menaxhimin dhe kontrollin, duhet të marrin parasysh parimin e proporcionalitetit duke pasur parasysh nivelin e mbështetjes së alokuar, duke ulur kështu barrën administrative dhe duke lehtësuar zbatimin efikas.

##### Neni 12

#### **Partneriteti**

1. Secili shtet anëtar, në përputhje me rregullat dhe praktikat e tij të brendshme dhe sipas çdo kërkesë të zbatueshme të sigurisë, organizon një partneritet me autoritetet dhe organet përkatëse për të përmbushur rolin e përcaktuar në paragrafin 3. Partneriteti krijohet nga autoritetet përkatëse publike në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal, aty ku është e zbatueshme. Gjithashtu, aty ku shihet e përshtatshme, përfshin organizatat ndërkombëtare, organizatat joqeveritare dhe partnerët socialë përkatës.

2. Partneriteti kryhet në përputhje të plotë me juridiksionin përkatës institucional, juridik dhe financiar të secilës kategori partnere.

3. Shteti anëtar përfshin partneritetin në përgatitjen, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e programeve kombëtare. Përbërja e partneritetit mund të ndryshojë në faza të ndryshme të programit.

4. Çdo shtet anëtar ngre një komitet monitorues për të mbështetur zbatimin e programeve kombëtare.

5. Komisioni mund të ofrojë udhëzime për monitorimin e programeve kombëtare dhe, kur është e nevojshme dhe në marrëveshje me shtetin anëtar në fjalë, mund të marrë pjesë në punën e komitetit të monitorimit në cilësinë e këshilltarit.

## Neni 13

### **Dialogu politik**

1. Për të lehtësuar përgatitjen e programeve kombëtare, secili shtet anëtar dhe Komisioni zhvillojnë një dialog në nivelin e zyrtarëve të lartë, duke marrë parasysh afatet kohore përkatëse të përcaktuara në nenin 14. Dialogu përqendrohet në rezultatet e përgjithshme që duhet të arrihen nëpërmjet programeve kombëtare me qëllim adresimin e nevojave dhe prioriteteve të shteteve anëtare në fushat e ndërhyrjes të mbuluara nga rregulloret e veçanta, duke marrë parasysh situatën bazë në shtetin anëtar dhe objektivat e rregulloreve specifike. Dialogu shërben gjithashtu si një mundësi për të shkëmbyer pikëpamjet për veprimet e BE-së. Rezultati i dialogut shërben si një udhëzues për përgatitjen dhe miratimin e programeve kombëtare dhe duhet të përfshijë një tregues për datën e pritshme të dorëzimit të programeve kombëtare të shtetit anëtar në Komision, gjë e cila do të mundësojë miratimin në kohë të programit. Ai rezultat regjistrohet në një procesverbal të miratuar.

2. Në rastin e veprimeve që do të zbatohen në dhe në raport me vendet e treta, këto veprime nuk janë drejtpërdrejtë të orientuara drejt zhvillimit dhe dialogu i politikave kërkon koherencë të plotë me parimet dhe objektivat e përgjithshme të veprimit të jashtëm të BE-së dhe politikën e jashtme në lidhje me vendin ose rajonin në fjalë.

3. Pas përfundimit të dialogut të politikave, Komisioni informon Parlamentin Evropian për rezultatin e përgjithshëm.

4. Nëse konsiderohet e përshtatshme nga një shtet anëtar dhe nga Komisioni, dialogu i politikave mund të përsëritet pas rishikimit afatmesëm të përmendur në nenin 15, me qëllim që të rivlerësojë nevojat e atij shteti anëtar dhe prioritetet e BE-së.

## Neni 14

### **Përgatitja dhe miratimi i programeve kombëtare**

1. Çdo shtet anëtar propozon, në bazë të rezultatit të dialogut të politikave të përmendur në nenin 13, paragrafi 1, një program kombëtar shumëvjeçar në përputhje me rregulloret specifike.

2. Çdo program kombëtar i propozuar mbulon vitet financiare të periudhës prej 1 janarit 2014 deri më 31 dhjetor 2020 dhe përbëhet nga elementët e mëposhtëm:

a) një përshkrim të situatës bazë në shtetin anëtar, i plotësuar me informacionin e nevojshëm faktik për të vlerësuar saktë kërkesat;

b) një analizë të kërkesave në shtetin anëtar dhe objektivat kombëtare të hartuara për të përmbushur këto kërkesa gjatë periudhës së mbuluar nga programi;

c) një strategji të përshtatshme që identifikon objektivat që duhet të ndiqen me mbështetjen e buxhetit të BE-së, me synimet për arritjen e tyre, një kalendar tregues dhe shembuj të veprimeve të parashikuara për përmbushjen e këtyre objektiveve;

d) një përshkrim se si janë mbuluar objektivat e rregulloreve specifike;

e) mekanizmat që sigurojnë bashkërendimin ndërmjet instrumenteve të përcaktuara nga rregulloret specifike dhe instrumentet e tjera të BE-së dhe ato të brendshme;

f) informacionet për kuadrin e monitorimit dhe vlerësimit që duhet të ngrihen dhe treguesit që do të përdoren për të matur progresin në zbatimin e objektivave të ndjekura në lidhje me situatën bazë në shtetin anëtar;

g) Dispozitat zbatuese për programin kombëtar që përfshijnë identifikimin e autoriteteve kompetente dhe një përshkrim përmbledhës të sistemit të menaxhimit dhe kontrollit të parashikuar;

h) një përshkrim përmbledhës i qasjes së zgjedhur për zbatimin e parimit të partneritetit të përcaktuar në nenin 12;

I. një projekt-plan financimi i ndarë sipas treguesve për secilin vit financiar të periudhës, duke përfshirë një tregues të shpenzimeve të asistencës teknike;

j) mekanizmat dhe metodat që do të përdoren për të publikuar programin kombëtar.

3. Shtetet anëtare i dorëzojnë Komisionit programet kombëtare të propozuara jo më vonë se tre muaj pas përfundimit të dialogut të politikave të përmendura në nenin 13.

4. Komisioni miraton, nëpërmjet akteve zbatuese, modelin sipas të cilit hartohen programet kombëtare. Këto akte zbatuese miratohen në përputhje me procedurën e shqyrtimit të përmendur në nenin 59, paragrafi 3.

5. Përpara miratimit të një programi kombëtar të propozuar, Komisioni shqyrton:

a) konsistencën e tij me objektivat e rregulloreve specifike dhe rezultatin e dialogut të politikave të përmendur në nenin 13, paragrafi 1;

b) shpërndarjen e financimit të BE-së midis objektivave duke marrë në konsideratë kërkesat e rregulloreve specifike dhe, kur është e nevojshme, arsyetimin për çdo devijim nga përqindjet minimale të përcaktuara në rregulloret specifike;

c) rëndësinë e objektivave, synimeve, treguesve, kalendarit dhe shembujve të veprimeve të parashikuara në programin kombëtar të propozuar në kuadër të strategjisë së propozuar nga shtetet anëtare;



d) rëndësinë e dispozitave zbatuese të përmendura në germën "g" të paragrafit 2, në kuadër të veprimeve të parashikuara;

e) pajtueshmërinë e programit të propozuar me legjislacionin e BE-së;

f) plotësimin me mbështetjen e dhënë nga fonde të tjera të BE-së, përfshirë Fondin Evropian Social;

g) aty ku është e zbatueshme sipas një rregulloreje specifike, për objektivat dhe shembujt e veprimeve në ose në lidhje me vende të treta, koherencën me parimet dhe objektivat e përgjithshme të veprimit të jashtëm të BE-së dhe politikës së jashtme që lidhet me vendin ose rajonin në fjalë.

6. Komisioni jep komentet e veta brenda tre muajve nga data e dorëzimit të programit kombëtar të propozuar. Kur Komisioni konsideron se një program i propozuar kombëtar është në kundërshtim me objektivat e rregullores specifike, në kuadër të strategjisë kombëtare, ose se fondet e BE-së që duhet t'u alokohen këtyre objektivave janë të pamjaftueshme ose se programi nuk është në përputhje me legjislacionin e BE-së, ai fton shtetin anëtar në fjalë që të paraqesë të gjitha informacionet e nevojshme shtesë dhe, sipas rastit, të ndryshojë programin e propozuar kombëtar.

7. Komisioni miraton çdo program kombëtar jo më vonë se gjashtë muaj pas paraqitjes formale nga shteti anëtar, me kusht që çdo koment i bërë nga Komisioni të jetë marrë parasysh në mënyrën e duhur.

8. Pa cenuar paragrafin 7, Komisioni informon Parlamentin Evropian për rezultatin e përgjithshëm të zbatimit të paragrafëve 5 dhe 6, duke përfshirë pajtueshmërinë me ose derogimin nga përqindjet minimale të përcaktuara për çdo objektiv në rregulloret specifike përkatëse.

9. Në kuadër të rrethanave të reja ose të paparashikuara, me iniciativën e Komisionit ose të shtetit anëtar në fjalë, një program kombëtar i miratuar mund të rishqyrtohet dhe, nëse është e nevojshme, të rishikohet për pjesën e mbetur të periudhës së programimit.

Neni 15

### **Rishikimi afatmesëm**

1. Në vitin 2018, Komisioni dhe çdo shtet anëtar rishikojnë situatën, në kuadër të raporteve të përkohshme të vlerësimit të paraqitura nga shtetet anëtare në përputhje me germën "a" të nenit 57, paragrafi 1, dhe në kuadër të zhvillimeve në politikën e BE-së dhe në shtetin anëtar në fjalë.

2. Pas rishikimit të përmendur në paragrafin 1 dhe në kuadër të rezultateve të tij, programet kombëtare mund të rivlerësohen.

3. Rregullat e përcaktuara në nenin 14 për përgatitjen dhe miratimin e programeve kombëtare zbatohen rast pas rasti për përgatitjen dhe miratimin e programeve kombëtare të rishikuara.

4. Pas përfundimit të rishikimit afatmesëm dhe si pjesë e vlerësimit të përkohshëm të përmendur në germën "a" të nenit 57, paragrafi 2, Komisioni raporton për rishikimin afatmesëm në Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve.

## Neni 16

### **Struktura e financimit**

1. Kontributet financiare të siguruara në zbatim të programeve kombëtare marrin formën e granteve.

2. Veprimet në zbatim të programeve kombëtare bashkëfinancohen nga burime publike ose private, janë me natyrë jofitimprurëse dhe nuk janë subjekt i financimit nga burime të tjera të mbuluara nga buxheti i BE-së.

3. Kontributi nga buxheti i BE-së nuk duhet të kalojë 75% të shpenzimeve totale të pranueshme të një projekti.

4. Kontributi nga buxheti i BE-së mund të rritet në 90% në zbatim të veprimeve specifike ose prioriteteve strategjike siç përcaktohen në rregulloret specifike.

5. Kontributi nga buxheti i BE-së mund të rritet në 90% në rrethana plotësisht të justifikuar, për shembull kur, për shkak të trysnisë ekonomike mbi buxhetin kombëtar, projektet nuk do të zbatoheshin dhe objektivat e programit kombëtar nuk do të arriheshin.

6. Kontributi nga buxheti i BE-së për asistencën teknike me iniciativën e shteteve anëtare mund të arrijë deri në 100% të totalit të shpenzimeve të pranueshme.

## Neni 17

### **Parimet e përgjithshme të pranueshmërisë**

1. Pranueshmëria e shpenzimeve përcaktohet në bazë të rregullave kombëtare, përveç rasteve kur në këtë rregullore ose në rregulloret specifike përcaktohen rregulla të veçanta.

2. Në përputhje me rregulloret specifike, që shpenzimet të jenë të pranueshme, ato duhet të jenë:

- a) brenda fushës së zbatimit të rregulloreve specifike dhe objektivave të tyre;
- b) të nevojshme për të kryer aktivitetet e mbuluara nga projekti në fjalë;
- c) të arsyeshme dhe në përputhje me parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar, në veçanti raporti cilësi/çmim dhe kosto-efektivitet.

3. Shpenzimet janë të pranueshme për mbështetje sipas rregulloreve specifike nëse:

- a) janë kryer nga një përfitues ndërmjet 1 janarit 2014 dhe 31 dhjetorit 2022; dhe

b) janë shpërndarë nga autoriteti përgjegjës i caktuar ndërmjet 1 janarit 2014 dhe 30 qershorit 2023.

4. Duke deroguar nga paragrafi 3, shpenzimet e paguara në 2014 janë gjithashtu të pranueshme kur janë paguar nga autoriteti përgjegjës përpara caktimit të tij formal në përputhje me nenin 26, me kusht që sistemet e menaxhimit dhe të kontrollit të zbatuara përpara caktimit formal janë në thelb të njëjta me ato në fuqi pas caktimit formal të autoritetit përgjegjës.

5. Shpenzimet e përfshira në kërkesat e pagesës nga përfituesi tek autoriteti përgjegjës mbështeten me fatura ose dokumente kontabël me forcë provuese të barasvlershme, përveç formave të mbështetjes në zbatim të germave "b", "c" dhe "d" të nenit 18, paragrafi 1. Për këto forma të mbështetjes, duke deroguar nga paragrafi 3 i këtij neni, shumat e përfshira në kërkesën për pagesë janë të barabarta me koston e rimbursuar për përfituesin nga autoriteti përgjegjës.

6. Të ardhurat neto të gjeneruara drejtpërdrejt nga një projekt gjatë zbatimit të tij, të cilat nuk janë marrë parasysh në kohën e miratimit të projektit, zbriten nga shpenzimet e pranueshme të projektit jo më vonë se në kërkesën përfundimtare të pagesës të dorëzuar nga përfituesi.

## Neni 18

### **Shpenzimet e pranueshme**

1. Shpenzimet e pranueshme mund të rimbursohen në mënyrat e mëposhtme:

a) rimbursimi i kostove të pranueshme realisht të mbuluara dhe të paguara, duke përfshirë, sipas rastit, amortizimin;

b) nivelet standarde të kostove për njësi;

c) shumat të përgjithshme;

d) financimi me normë të sheshtë i vendosur nga zbatimi i një përqindjeje ndaj një ose më tepër kategorive të kostove.

2. Opsionet e përmendura në paragrafin 1 mund të kombinohet ku çdo opsion mbulon kategori të ndryshme kostosh, ose ku ato përdoren për projekte të ndryshme që formojnë një pjesë të një veprimi ose për fazat e mëtejshme të një veprimi.

3. Kur një projekt zbatohet ekskluzivisht përmes prokurimit publik të punëve, të mirave ose shërbimeve, zbatohet vetëm germa "a" e paragrafit 1. Kur prokurimi publik në një projekt bëhet vetëm për disa kategori kostosh, mund të zbatohen të gjitha opsionet e përmendura në paragrafin 1.

4. Shumat e përmendura në gerrat "b", "c" dhe "d" të paragrafit 1 përcaktohen në një nga mënyrat e mëposhtme:

a) një metodë përlllogaritjeje e drejtë, e barabartë dhe e verifikueshme bazuar në:

I. të dhëna statistikore ose informacione të tjera objektive;

II. të dhënat e verifikuara historike të përfituesve individualë; ose

III. zbatimin e praktikave të zakonshme të kontabilitetit të kostove të përfituesve individualë;

b) në përputhje me rregullat për zbatimin e nivelit standard të kostove për njësi, shumës totale dhe normave të sheshta të zbatueshme në politikat e BE-së për një lloj të ngjashëm projekti dhe përfituesi;

c) në përputhje me rregullat për zbatimin e nivelit standard të kostove për njësi, shumës totale dhe normave të sheshta të zbatueshme sipas skemave për grante të financuara tërësisht nga shteti anëtar në fjalë për një lloj të ngjashëm projekti dhe përfituesi.

5. Dokumenti që përcakton kushtet për mbështetje për çdo projekt, përcakton metodën që do të zbatohet për të përcaktuar kostot e projektit dhe kushtet për pagesën e grantit.

6. Kur zbatimi i një projekti krijon kosto të tërthorta, ato mund të llogariten si një normë e sheshtë në një nga mënyrat e mëposhtme:

a) një normë e sheshtë deri në 25 % të kostove të pranueshme të drejtpërdrejta, me kusht që norma të llogaritet mbi bazat e një metode përlllogaritjeje të drejtë, të barabartë dhe të verifikueshme ose një metode të zbatuar sipas skemave të granteve të financuara tërësisht nga shteti anëtar në fjalë për një lloj të ngjashëm projekti dhe përfituesi;

b) një normë e sheshtë deri në 15 % të kostove të pranueshme të drejtpërdrejta të stafit pa një kërkesë që shteti anëtar në fjalë të kryejë një llogaritje për të përcaktuar normën e zbatueshme;

c) një normë e sheshtë e zbatuar për kostot e pranueshme të drejtpërdrejta të bazuara në metoda ekzistuese dhe normat përkatëse, e zbatueshme në politikat e BE-së për një lloj të ngjashëm projekti dhe përfituesi.

7. Për qëllimet e përcaktimit të kostove të stafit që lidhen me zbatimin e një projekti, norma e zbatueshme për orë mund të llogaritet duke pjesëtuar kostot më të fundit vjetore bruto të punës të dokumentuara me 1720 orë.

8. Përveç metodave të përcaktuara në paragrafin 4, kur kontributi nga buxheti i BE-së nuk kalon 100 000 euro, shumat e përmendura në gerat "b", "c" dhe "d" të paragrafit 1 mund të përcaktohen rast pas rasti duke iu referuar një draft buxheti të miratuar paraprakisht nga autoriteti përgjegjës.

9. Kostot e amortizimit mund të konsiderohen si të pranueshme kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) e lejojnë rregullat e pranueshmërisë së programit kombëtar;

b) shuma e shpenzimeve arsyetohet siç duhet nga dokumentet mbështetëse me vlera provuese të njëjta me faturat për kostot e pranueshme, kur rimbursohen në formën e përmendur në germën "a" të paragrafit 1;

c) kostot lidhen ekskluzivisht me periudhën e mbështetjes për projektin;

d) mbështetja nga buxheti i BE-së nuk ka kontribuar në blerjen e aseteve të amortizuara.

10. Pa cenuar nenin 43, për qëllimet e paragrafit 8 të këtij neni shtetet anëtare monedha e të cilave nuk është euro, mund të përdorin normën e konvertimit në euro të caktuar në datën e miratimit të projektit ose nënshkrimit të marrëveshjes së projektit bazuar në kursin mujor të këmbimit kontabël të publikuar në mënyrë elektronike nga Komisioni. Norma e konvertimit në euro nuk pëson ndryshime në rrjedhën e projektit.

#### Neni 19

### **Shpenzimet e papranueshme**

Kostot e mëposhtme nuk janë të pranueshme për një kontribut nga Buxheti i BE-së sipas rregulloreve specifike:

a) interesi mbi borxhin;

b) blerja e trojeve mbi të cilat nuk është ndërtuar;

c) blerja e trojeve mbi të cilat është ndërtuar, kur trualli është i nevojshëm për zbatimin e projektit, në një shumë që e tejkalon 10 % të totalit të shpenzimeve të pranueshme për projektin në fjalë;

d) tatimin mbi vlerën shtuar (TVSH), përveç rasteve kur nuk është i rikuperueshëm sipas legjislacionit të brendshëm për TVSH-në.

#### Neni 20

### **Asistenca teknike me iniciativë të shteteve anëtare**

1. Me iniciativën e një shteti anëtar për secilin program kombëtar, rregulloret specifike mund të mbështesin veprimet për përgatitjen, menaxhimin, monitorimin, vlerësimin, informimin dhe komunikimin, rrjetëzimin, kontrollin dhe auditimin, si dhe masat për përfundimin e kapacitetit administrativ për zbatimin e kësaj rregulloreje dhe rregulloreve specifike.

2. Masat e përmendura në paragrafin 1 mund të përfshijnë:

a) shpenzimet që lidhen me përgatitjen, përzgjedhjen, vlerësimin, menaxhimin dhe monitorimin e programit, veprimeve ose projekteve;

b) shpenzimet që lidhen me auditimet dhe kontrollet në terren të veprimeve ose projekteve;

c) shpenzimet që lidhen me vlerësimet e programit, veprimeve ose projekteve;

d) shpenzimet që lidhen me informacionin, shpërndarjen dhe transparencën në lidhje me programin, veprimet ose projektet, duke përfshirë shpenzimet që rrjedhin nga zbatimi i nenit 53 dhe shpenzimet për fushatat për të informuar dhe rritur ndërgjegjësimin në lidhje me qëllimin e programit, të organizuar, ndër të tjera, në nivel lokal;

e) shpenzimet për blerjen, instalimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve kompjuterike për menaxhimin, monitorimin dhe vlerësimin e kësaj rregulloreje dhe rregulloreve specifike;

f) shpenzimet për mbledhjet e komisioneve dhe nënkomisioneve monitoruese në lidhje me zbatimin e veprimeve; duke përfshirë kostot e ekspertëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në ato komitete dhe duke përfshirë pjesëmarrësit e vendeve të treta, kur prania e tyre është thelbësore për zbatimin efektiv të programeve, veprimeve ose projekteve;

g) shpenzimet për përforcimin e kapacitetit administrativ për zbatimin e kësaj rregulloreje dhe rregulloreve specifike.

3. Shumat e përcaktuara mund të përdoren nga shtetet anëtare për të mbështetur masat për uljen e barrës administrative për përfituesit dhe autoritetet kompetente të përmendura në nenin 25, përfshirë sistemin e shkëmbimit të të dhënave elektronike, si edhe aksionet për të forcuar kapacitetet e autoriteteve të shteteve anëtare dhe përfituesve në lidhje me administrimin dhe përdorimin e mbështetjes së parashikuar në rregulloret specifike.

4. Këto veprime mund të prekin kuadro financiare të mëparshme dhe të mëvonshme.

5. Kur një ose më shumë autoritete kompetente janë të përbashkëta për më shumë se një program kombëtar, shumat e përcaktuara për shpenzimet e asistencës teknike për secilin nga programet në fjalë mund të bashkohen, pjesërisht ose tërësisht.

## SEKSIONI 2

### MENAXHIMI DHE KONTROLLI

#### Neni 21

#### **Parimet e përgjithshme të sistemeve të menaxhimit dhe të kontrollit**

Për zbatimin e programit të tij kombëtar, çdo shtet anëtar krijon sisteme të menaxhimit dhe të kontrollit, të cilat parashikojnë:

a) një përshkrim të funksioneve të çdo autoriteti të përfshirë në menaxhimin, kontrollin, dhe alokimin e funksioneve brenda secilit autoritet;

b) përputhshmërinë me parimin e ndarjes së funksioneve midis dhe brenda autoriteteve të tilla;

c) procedurat për garantimin e korrektësisë dhe të rregullsisë së shpenzimeve të deklaruara;

d) sistemet e kompjuterizuara për kontabilizimin, ruajtjen dhe transmetimin e të dhënave financiare dhe të dhënave mbi treguesit, për monitorimin dhe raportimin;

e) sistemet për raportimin dhe monitorimin ku autoriteti përgjegjës ia beson ekzekutimin e detyrave një organi tjetër;

f) masat për auditin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit;

g) sistemet dhe procedurat për të siguruar një gjurmë të përshtatshme të auditit;

h) parandalimin, zbulimin dhe korigjimin e parregullsive, duke përfshirë mashtrimin, si dhe rikuperimin e shumave të paguara padrejtësisht, së bashku me çdo kamatvonesë.

Neni 22

### **Përgjegjësitë në menaxhimin e përbashkët**

Në përputhje me parimin e menaxhimit të përbashkët, shtetet anëtare dhe Komisioni janë përgjegjës për menaxhimin dhe kontrollin e programeve kombëtare sipas përgjegjësisë të tyre përkatëse të përcaktuara në këtë rregullore dhe në rregulloret specifike.

Neni 23

### **Përgjegjësitë e përfituesve**

Përfituesit bashkëpunojnë plotësisht me Komisionin dhe autoritetet kompetente kur kryejnë funksionet dhe detyrat e tyre në lidhje me këtë rregullore dhe rregulloret specifike.

Neni 24

### **Përgjegjësitë e shteteve anëtare**

1. Shtetet anëtare përmbushin detyrimet e menaxhimit, kontrollit dhe auditit dhe marrin përgjegjësitë përkatëse, të cilat përcaktohen në rregullat për menaxhimin e përbashkët të përcaktuara në Rregulloren (BE, Euratom) nr. 966/2012 dhe në këtë rregullore.

2. Shtetet anëtare sigurohen që sistemet e tyre të menaxhimit dhe të kontrollit për programet kombëtare të ngrihen në përputhje me këtë rregullore dhe që ato sisteme të funksionojnë në mënyrë efektive.

3. Shtetet anëtare alokojnë burime të përshtatshme për çdo autoritet kompetent që ata të kryejnë funksionet e tyre gjatë gjithë periudhës së programimit.

4. Shtetet anëtare krijojnë rregulla dhe procedura transparente për përzgjedhjen dhe zbatimin e projekteve në përputhje me këtë rregullore dhe rregulloret specifike.

5. Të gjitha shkëmbimet zyrtare të informacionit ndërmjet shtetit anëtar dhe Komisionit kryhen duke përdorur një sistem elektronik për shkëmbimin e të dhënave. Komisioni përcakton, nëpërmjet akteve zbatuese, kushtet të cilat duhet të përmbushë sistemi i shkëmbimit elektronik të të dhënave. Këto akte zbatuese miratohen në përputhje me procedurën e shqyrtimit të përmendur në nenin 59, paragrafi 3.

## Neni 25

### **Autoritetet kompetente**

1. Për qëllimet e kësaj rregulloreje dhe rregulloreve specifike, autoritetet kompetente janë:

a) autoriteti përgjegjës: një organ i sektorit publik të shtetit anëtar në fjalë, i cili është organi i caktuar sipas kuptimit të nenit 59, paragrafi 3 të Rregullores (BE, Euratom) nr. 966/2012 dhe i cili është përgjegjës vetëm për menaxhimin dhe kontrollin e duhur të programit kombëtar dhe merret me të gjitha komunikimet me Komisionin;

b) autoriteti i auditit: një autoritet ose organ publik kombëtar, i cili është funksionalisht i pavarur nga autoriteti përgjegjës dhe i cili është përgjegjës për nxjerrjen e përvitshme të opinionit të përmendur në nënparagrafin e dytë të nenit 59, paragrafi 5 të Rregullores (BE, Euratom) nr. 966/2012;

c) sipas rastit, një ose më shumë autoritete të deleguara: çdo organ publik ose privat që kryen detyra të caktuara të autoritetit përgjegjës nën përgjegjësinë e autoritetit përgjegjës.

2. Çdo shtet anëtar përcakton rregullat që rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet autoriteteve të përmendura në paragrafin 1 dhe marrëdhëniet e tyre me Komisionin.

## Neni 26

### **Caktimi i autoriteteve përgjegjëse**

1. Shtetet anëtare njoftojnë Komisionin për caktimin formal, në përputhje me nenin 59, paragrafi 3 të Rregullores (BE, Euratom) nr. 966/2012, në nivel ministror të autoriteteve përgjegjëse në shtetet anëtare përgjegjëse për menaxhimin dhe kontrollin e shpenzimeve sipas kësaj rregulloreje, sa më shpejt që të jetë e mundur pas miratimit të programit kombëtar.

2. Caktimi i përmendur në paragrafin 1 bëhet për organin që përmbush kriteret e caktimit për mjedisin e brendshëm, aktivitetet e kontrollit, informimin dhe komunikimin dhe monitorimin e përcaktuar në ose që është në bazë të kësaj rregulloreje.

3. Përcaktimi i një autoriteti përgjegjës bazohet në opinionin e një organi auditit, i cili mund të jetë autoriteti i auditit, që vlerëson përputhjen e autoritetit përgjegjës me kriteret e përcaktimit. Ky organ mund të jetë institucioni i pavarur publik përgjegjës për monitorimin, vlerësimin dhe auditimin e administratës. Organi i auditimit funksionon në mënyrë të pavarur nga autoriteti përgjegjës dhe kryen punën e tij në përputhje me standardet e auditimit të pranuar ndërkombëtarisht. Në përputhje me nenin 59, paragrafi 3 të Rregullores (BE, Euratom) nr.



966/2012, shtetet anëtare mund të bazojnë vendimin e tyre për caktimin në faktin nëse sistemet e menaxhimit dhe kontrollit janë në thelb të njëjta me ato të vendosura për periudhën e mëparshme dhe nëse ato kanë funksionuar në mënyrë efektive. Nëse rezultatet ekzistuese të auditimit dhe të kontrollit tregojnë se organet e caktuara nuk i përmbushin më kriteret e caktimit, shtetet anëtare duhet të marrin masat e nevojshme për të siguruar që mangësitë në zbatimin e detyrave të këtyre organeve të përmirësohen, duke përfshirë edhe heqjen e caktimit.

4. Për të siguruar funksionimin e mirë të këtij sistemi, Komisioni autorizohet të miratojë aktet e deleguara në përputhje me nenin 58 lidhur me:

a) kushtet minimale për caktimin e autoriteteve përgjegjëse në lidhje me mjedisin e brendshëm, aktivitetet e kontrollit, informimin dhe komunikimin dhe monitorimin, si dhe rregullat për procedurën për fillimin dhe mbarimin e caktimit;

b) rregullat që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen dhe procedurën për rishikimin e caktimit të autoriteteve përgjegjëse;

c) detyrimet e autoriteteve përgjegjëse në lidhje me ndërhyrjen publike, si edhe për përmbajtjen e përgjegjësive të tyre të menaxhimit dhe të kontrollit.

Neni 27

### **Parimet e përgjithshme mbi kontrollin nga autoritetet përgjegjëse**

1. Autoritetet përgjegjëse kryejnë një kontroll administrativ sistematik dhe plotësojnë një kontroll të tillë nëpërmjet kontrolleve në terren, duke përfshirë, kur është e përshtatshme, kontrolle të paparalajmëruara në terren të shpenzimeve që lidhen me kërkesat përfundimtare të pagesës nga përfituesit që janë deklaruar në llogaritë vjetore, me qëllim sigurimin e një niveli të mjaftueshëm të sigurimit.

2. Për sa u përket kontrolleve në terren, autoriteti përgjegjës nxjerr kampionin e tij të kontrollit nga e gjithë popullata e përfituesve që përfshin, sipas rastit, një pjesë të rastësishme dhe një pjesë të bazuar në rrezik, me qëllim të përfundimit të shkallës së gabimit përfaqësues dhe të një niveli minimal besueshmërie, duke synuar edhe gabimet më të larta.

3. Autoriteti përgjegjës harton një raport kontrolli për çdo kontroll në terren.

4. Aty ku problemet e zbuluara duket se janë sistematike në natyrë dhe prandaj mund të sjellin rrezik për projekte të tjera, autoriteti përgjegjës siguron që të kryhet një ekzaminim i mëtejshëm, duke përfshirë kontrollet shtesë aty ku është e nevojshme, për të përcaktuar shkallën e këtyre problemeve dhe nëse shkalla e gabimit është mbi nivelin e pranueshëm. Masat e nevojshme parandaluese dhe korrigjuese merren nga autoriteti përgjegjës dhe i komunikohen Komisionit në përmbledhjen e përmendur në germën "b" të nënparagrafit të parë të nenit 59, paragrafi 5 i Rregullores (BE, Euratom) nr. 966/2012.

5. Nëpërmjet akteve zbatuese, Komisioni miraton rregullat e nevojshme që synojnë arritjen e një zbatimi të njëtrajtshëm të këtij neni. Këto rregulla mund të prekin veçanërisht çështjet e mëposhtme:

a) rregullat në lidhje me kontrollet administrative dhe ato në vend, duke përfshirë kontrollet e pa paralajmëruara në vend, që duhet të kryhen nga autoriteti përgjegjës në lidhje me përmbushjen e detyrimeve, angazhimeve dhe rregullave të përshtatshëm që rezultojnë nga zbatimi i kësaj rregulloreje dhe rregulloreve specifike, duke përfshirë rregullat në lidhje me periudhën kohore për të cilën duhet të mbahen dokumentet mbështetëse;

b) rregullat për nivelin minimal të kontrolleve në vend, të domosdoshme për një menaxhim të efektshëm të rreziqeve, si dhe kushtet sipas të cilave shtetet anëtare duhet të rrisin kontrollet e tilla ose mund t'i reduktojnë ato kur sistemet e menaxhimit dhe kontrollit funksionojnë si duhet dhe marzhet e gabimit janë në një nivel të pranueshëm;

c) rregullat dhe metodat për raportimin e kontrolleve dhe verifikimeve të kryera dhe rezultatet e tyre.

Këto akte zbatuese miratohen në përputhje me procedurën e shqyrtimit të përmendur në nenin 59, paragrafi 3.

## Neni 28

### **Pagesa për përfituesit**

Autoritetet përgjegjëse sigurohen që përfituesit të marrin shumën totale të mbështetjes publike të plotë dhe sa më shpejt që të jetë e mundur. Nuk do të zbritet apo mbahet asnjë shumë dhe nuk do të zbatohet asnjë pagesë specifike apo tjetër me efekt të barasvlershëm që mund të reduktojë këto shuma për përfituesit.

## Neni 29

### **Funksionet e autoritetit auditues**

1. Për të mbështetur opinionin e dhënë në përputhje me nenin 59 të Rregullores (BE, Euratom) nr. 966/2012, autoriteti auditues duhet të sigurojë që auditet të kryhen në sistemet e menaxhimit dhe kontrollit dhe në një kampion të përshtatshëm të shpenzimeve të përfshira në llogaritë vjetore. Komisioni autorizohet të miratojë akte të deleguara në përputhje me nenin 58 të kësaj rregulloreje për statusin e autoriteteve audituese dhe kushtet që duhet të përmbushin auditet e tyre.

2. Kur auditet kryhen nga një organ i ndryshëm nga autoriteti auditues, ky i fundit siguron që çdo organ i tillë ka ekspertizën e nevojshme dhe pavarësinë funksionale.

3. Autoriteti auditues siguron që puna e auditit përmbush standardet e auditit të pranuar ndërkombëtarisht.

## Neni 30

### **Bashkëpunimi me autoritetet audituese**

1. Komisioni bashkëpunon me autoritetet audituese për të koordinuar planet dhe metodat e tyre përkatëse të auditimit dhe shkëmben rezultatet e auditëve të kryera në sistemet e menaxhimit dhe kontrollit sa më shpejt që të jetë e mundur, në mënyrë që të kryejë përdorimin më të mirë të mundshëm dhe të përpjesëtohet të burimeve të kontrollit dhe për të shmangur duplikimin e pajustificuar të punës.

2. Komisioni dhe autoritetet audituese takohen rregullisht për të shkëmbyer pikëpamje për çështjet që kanë të bëjnë me përmirësimin e sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit.

## Neni 31

### **Kontrollet dhe auditet nga Komisioni**

1. Komisioni mbështetet në informacionin e disponueshëm, duke përfshirë procedurën e caktimit, kërkesën për pagesën e bilancit vjetor sipas nenit 44, raportet vjetore të zbatimit dhe auditet e kryera nga organet kombëtare dhe të BE-së, për të vlerësuar nëse shtetet anëtare kanë krijuar sisteme të menaxhimit dhe të kontrollit në përputhje me këtë rregullore dhe nëse ato sisteme funksionojnë në mënyrë efektive gjatë zbatimit të programeve kombëtare.

2. Pa cenuar auditet e kryera nga shtetet anëtare, zyrtarët e Komisionit ose përfaqësuesit e autorizuar të Komisionit mund të kryejnë audite ose kontrolle në terren pas njoftimit të paktën 12 ditë pune përpara ndaj autoritetit kombëtar kompetent, përveç rasteve urgjente. Komisioni respekton parimin e proporcionalitetit duke marrë parasysh nevojën për të shmangur duplikimin e pajustificuar të auditëve ose kontrolleve të kryera nga shtetet anëtare, nivelin e rrezikut për buxhetin e BE-së dhe nevojën për të minimizuar barrën administrative për përfituesit. Zyrtarët ose përfaqësuesit e autorizuar të shtetit anëtar mund të marrin pjesë në këto audite ose kontrolle.

3. Fusha e zbatimit të auditëve mund të përfshijë veçanërisht:

a) verifikimin e funksionimit efektiv të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit në një program kombëtar ose një pjesë të tij;

b) përputhjen e praktikave administrative me rregullat e BE-së;

c) ekzistencën e dokumenteve mbështetëse të kërkuara dhe lidhjen e tyre me veprimet e mbështetura në zbatim të programeve kombëtare;

d) kushtet në të cilat janë ndërmarrë dhe kontrolluar veprimet;

e) një vlerësim të menaxhimit të shëndoshë financiar të veprimeve dhe/ose programit kombëtar.

4. Zyrtarët e Komisionit ose përfaqësuesit e autorizuar të Komisionit, me kompetenca për të kryer audite ose kontrolle në terren, kanë akses në të gjitha të dhënat, dokumentet dhe metadatat e nevojshme, pavarësisht nga mënyra në të cilën janë ruajtur ato, në lidhje me projektet dhe asistencën teknike ose me sistemet e menaxhimit dhe kontrollit. Shtetet anëtare, me kërkesë të Komisionit, i dërgojnë atij kopje të tilla të regjistrave, dokumenteve dhe metadatave. Kompetencat e përcaktuara në këtë paragraf nuk ndikojnë në zbatimin e dispozitave kombëtare,

të cilat rezervojnë disa akte për agjentët e caktuar posaçërisht nga legjislacioni i brendshëm. Zyrtarët e Komisionit dhe përfaqësuesit e autorizuar nuk do të marrin pjesë, ndër të tjera, në vizitat në shtëpi ose në marrjen në pyetje formale të personave brenda kuadrit të legjislacionit të brendshëm. Megjithatë, ata kanë akses në informatat e përfuara pa cenuar kompetencat e gjykatave kombëtare dhe në respektim të plotë të të drejtave themelore të subjekteve ligjore në fjalë.

5. Me kërkesën e Komisionit dhe me pëlqimin e shtetit anëtar në fjalë, kontrollet shtesë ose hetimet për veprimet që mbulon kjo rregullore ndërmerren nga organet kompetente të atij shteti anëtar. Agjentët e Komisionit ose personat e deleguar nga Komisioni mund të marrin pjesë në këto kontrolle. Për të përmirësuar kontrollet, Komisioni, me pëlqimin e shteteve anëtare në fjalë, mund të kërkojë ndihmën e autoriteteve të tyre për kontrolle ose hetime të caktuara.

6. Komisioni mund të kërkojë nga një shtet anëtar të ndërmarrë veprimet e nevojshme për të siguruar funksionimin efektiv të sistemeve të tij të menaxhimit dhe të kontrollit ose korrektësinë e shpenzimeve në përputhje me rregullat në fuqi.

### SEKSIONI 3

#### MENAXHIMI FINANCIAR

##### Neni 32

#### **Angazhimet buxhetore**

1. Angazhimet buxhetore të BE-së në lidhje me çdo program kombëtar paguhen në këste vjetore gjatë periudhës prej 1 janarit 2014 deri më 31 dhjetor 2020.

2. Vendimi i Komisionit për miratimin e një programi kombëtar përbën një vendim financimi në kuptim të nenit 84 të Rregullores (BE, Euratom) nr. 966/2012 dhe, sapo të njoftohet në shtetin anëtar në fjalë, një angazhim ligjor në kuptim të kësaj rregulloreje.

3. Për çdo program kombëtar, angazhimi buxhetor për këstin e parë vjen në vijim të miratimit të programit kombëtar nga Komisioni.

4. Angazhimet buxhetore për këstet e mëvonshme paguhen nga Komisioni përpara 1 majit të çdo viti, në bazë të vendimit të përmendur në paragrafin 2 të këtij neni, përveç rasteve kur zbatohet neni 16 i Rregullores (BE, Euratom) nr. 966/2012.

##### Neni 33

#### **Rregullat e përbashkëta për pagesën**

1. Pagesat e kontributit nga buxheti i BE-së që kryen Komisioni, në programin kombëtar bëhen në përputhje me shpërndarjen buxhetore dhe janë subjekt i fondeve në dispozicion. Çdo pagesë i bashkëngjitet angazhimit të hapur buxhetor më të parë.

2. Pagesat marrin formën e financimit paraprak fillestar, financimit paraprak vjetor, pagesave të bilancit vjetor dhe pagesës së bilancit përfundimtar.

3. Zbatohet neni 90 i Rregullores (BE, Euroatom) nr. 966/2012.

Neni 34

### **Akumulimi i financimit paraprak fillestar dhe i balanceve vjetore**

1. Totali i pagesës së financimit paraprak fillestar dhe pagesat e bilancit vjetor nuk duhet të kalojë 95% të kontributit nga buxheti i BE-së në programin kombëtar në fjalë.

2. Ku arrihet tavanin prej 95 %, shtetet anëtare mund të vazhdojnë t'i transmetojnë Komisionit kërkesa për pagesa.

Neni 35

### **Masat e financimit paraprak**

1. Pas vendimit të Komisionit për miratimin e programit kombëtar, brenda katër muajve paguhet një vlerë fillestare e financimit paraprak për të gjithë periudhën e programimit nga Komisioni tek autoriteti përgjegjës i caktuar. Kjo shumë fillestare e financimit paraprak përfaqëson 4% të kontributit të përgjithshëm nga buxheti i BE-së në programin kombëtar përkatës. Mund të ndahet në dy këste, në varësi të disponueshmërisë së buxhetit.

2. Para datës 1 shkurt 2015 duhet të paguhet një shumë vjetore e financimit paraprak prej 3% të kontributit të përgjithshëm nga buxheti i BE-së ndaj programit kombëtar në fjalë. Për vitet në periudhën 2016-22, ai përfaqëson 5% të kontributit të përgjithshëm nga buxheti i BE-së ndaj programit kombëtar përkatës.

3. Nëse një program kombëtar miratohet në vitin 2015 ose më vonë, financimi paraprak dhe financimi paraprak vjetor paguhet jo më vonë se 60 ditë pas miratimit të programit kombëtar, në varësi të disponueshmërisë së buxhetit.

4. Në rastin e ndryshimeve në kontributin e përgjithshëm nga buxheti i BE-së në një program kombëtar, shumat fillestare si dhe shumat vjetore të financimit paraprak duhet të rishikohen në përputhje me rrethanat dhe të pasqyrohen në vendimin e financimit.

5. Financimi paraprak përdoret për të bërë pagesa për përfituesit që zbatojnë programin kombëtar, si dhe për autoritetet kompetente për shpenzimet që kanë të bëjnë me asistencën teknike. Ajo u vihet pa vonësë në dispozicion autoriteteve përgjegjëse për ato qëllime.

Neni 36

### **Likuidimi i financimit paraprak**

1. Shuma e paguar si financim paraprak likuidohet plotësisht nga llogaritë e Komisionit në përputhje me nenin 40, jo më vonë se data e mbylljes së programit kombëtar.

2. Shuma e paguar si financim paraprak vjetor likuidohet nga llogaritë e Komisionit në përputhje me nenin 39.

3. Nëse brenda 36 muajve nga data në të cilën Komisioni paguan këstin e parë të vlerës së financimit paraprak nuk dërgohet asnjë kërkesë për pagesa sipas nenit 44, Komisionit i rimbursohet vlera e plotë e paguar si financim paraprak.

4. Interesi i gjeneruar në financimin paraprak fillestar i bashkëngjitet programit kombëtar përkatës dhe zbritet nga shuma e shpenzimeve publike të treguara në kërkesën përfundimtare të pagesës.

Neni 37

### **Të ardhurat e brendshme me destinacion të caktuar**

1. Sa më poshtë do të konsiderohen si të ardhura të brendshme me destinacion të caktuar në kuptimin e nenit 21 të Rregullores (BE, Euroatom) nr. 966/2012:

I. shuma të cilat, sipas neneve 45 dhe 47 të kësaj rregulloreje, i paguhet buxhetit të BE-së, së bashku me interesat;

II. shuma të cilat, pas mbylljes së programeve sipas kuadrit financiar shumëvjeçar të mëparshëm, i paguhen buxhetit të BE-së, së bashku me interesat.

2. Shumat e përmendura në paragrafin 1 i paguhen buxhetit të BE-së dhe, në rast ripërdorimi, përdoren në rastin më të parë për të financuar shpenzimet sipas rregulloreve specifike.

Neni 38

### **Përkufizimi i vitit financiar**

Për qëllimet e kësaj rregulloreje, viti financiar, siç përmendet në nenin 59 të rregullores (BE, Euroatom) nr. 966/2012, mbulon shpenzimet e paguara dhe të ardhurat e përfuara dhe të futura në llogaritë e autoritetit përgjegjës në periudhën që fillon në datë 16 tetor të vitit "N-1" dhe përfundon më 15 tetor të vitit "N".

Neni 39

### **Pagesa e bilancit vjetor**

1. Komisioni paguan bilancin vjetor, mbi bazën e planit financiar në fuqi, të llogarive vjetore për vitin financiar përkatës të programit kombëtar dhe vendimit përkatës për likuidim.

2. Llogaritë vjetore mbulojnë pagesat e kryera nga autoriteti përgjegjës, përfshirë pagesat që lidhen me asistencën teknike, gjatë vitit financiar për të cilin janë përmbushur kërkesat për kontroll që përmenden në nenin 27.

3. Në varësi të disponueshmërisë së buxhetit, bilanci vjetor paguhet jo më vonë se gjashtë muaj pasi informacioni dhe dokumentet e përmendura në nenin 44, paragrafi 1 dhe nenin 54 konsiderohen të pranueshme nga Komisioni dhe llogaritë e fundit vjetore janë shlyer.

#### Neni 40

### **Mbyllja e programit**

1. Përpara 31 dhjetorit 2023, shtetet anëtare dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

a) informacionin e kërkuar për llogaritë e fundit vjetore, në përputhje me nenin 44, paragrafi 1;

b) një kërkesë për pagesën e bilancit përfundimtar; dhe

c) raportin përfundimtar të zbatimit të programit kombëtar sipas nenit 54, paragrafi 1.

2. Pagesat e kryera nga autoriteti përgjegjës nga data 16 tetor 2022 deri më 30 qershor 2023, përfshihen në llogaritë e fundit vjetore.

3. Pas marrjes së dokumenteve të renditura në paragrafin 1, Komisioni paguan bilancin përfundimtar në bazë të planit financiar në fuqi, llogaritë e fundit vjetore dhe vendimin përkatës për likuidim.

4. Në varësi të disponueshmërisë së buxhetit, bilanci përfundimtar paguhet jo më vonë se tre muaj pas datës së likuidimit të llogarive të vitit financiar përfundimtar ose një muaj pas datës së pranimit të raportit përfundimtar të zbatimit, cilado qoftë data më e vonë. Shumat për t'u paguar pas pagimit të bilancit, pa cenuar nenin 52, anulohen nga Komisioni brenda një periudhe prej gjashtë muajsh.

#### Neni 41

### **Ndërprerja e afatit të pagesës**

1. Afati i pagesës pas një kërkesë për pagesë mund të ndërpritet nga zyrtari autorizues përmes delegimit në kuptimin e rregullores (BE, Euratom) nr. 966/2012 për një periudhë maksimale prej gjashtë muajsh, kur plotësohet të paktën një nga kushtet e mëposhtme:

a) përveç informacioneve të siguruara nga një organ i auditimit kombëtar ose i BE-së, ka dëshmi të qarta për një mangësi të konsiderueshme në funksionimin e sistemit të menaxhimit dhe të kontrollit;

b) zyrtari autorizues përmes delegimit duhet të kryejë verifikime shtesë duke ndjekur informacionin e sjellë në vëmendjen e tij, që e njofton se shpenzimet në një kërkesë pagese janë të lidhura me një parregullsi që ka pasojë financiare të rënda;

c) një ose më shumë dokumente të kërkuara sipas nenit 44, paragrafi 1 nuk janë dorëzuar.

Shteti anëtar i interesuar mund të pajtohet me një shtyrje të periudhës së ndërprerjes për tre muaj të tjerë.

2. Zyrtari autorizues përmes delegimit e kufizon ndërprerjen për pjesën e shpenzimeve të mbuluara nga kërkesa e pagesës që preket nga elementet e përmendura në nënparagrafin e parë të paragrafit 1, përveç se kur është e pamundur të përcaktohet pjesa e shpenzimeve të prekura. Zyrtari autorizues përmes delegimit njofton menjëherë shtetin anëtar dhe autoritetin përgjegjës për arsyen e ndërprerjes dhe kërkon nga ata që të përmirësojnë situatën. Ndërprerja përfundohet nga zyrtari autorizues përmes delegimit sapo të jenë marrë masat e nevojshme.

Neni 42

### **Pezullimi i pagesave**

1. Komisioni mund të pezullojë të gjithë ose një pjesë të bilancit vjetor kur:

a) ka një mangësi serioze në funksionimin efektiv të sistemit të menaxhimit dhe kontrollit të programit kombëtar, i cila ka vënë në rrezik kontributin e BE-së në programin kombëtar dhe për të cilën nuk janë ndërmarrë masa korrigjuese;

b) shpenzimet në llogaritë vjetore lidhen me një parregullsi që ka pasojë financiare të rënda, të cilat nuk janë korrigjuar; ose

c) shteti anëtar nuk ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për të korrigjuar situatën që ka shkaktuar ndërprerje sipas nenit 41.

2. Komisioni mund të vendosë të pezullojë të gjithë ose një pjesë të bilancit vjetor pasi i ka dhënë shtetit anëtar në fjalë mundësinë për të paraqitur vërejtjet e tij.

3. Komisioni i jep fund pezullimit të të gjithë ose një pjese të bilancit vjetor, kur shteti anëtar përkatës ka marrë masat e nevojshme për të mundësuar heqjen e pezullimit.

Neni 43

### **Përdorimi i euros**

1. Shumat e përcaktuara në programet kombëtare të paraqitura nga shtetet anëtare, parashikimet e shpenzimeve, deklaratat e shpenzimeve, kërkesat për pagesa, llogaritë vjetore dhe shpenzimet e përmendura në raportet vjetore dhe përfundimtare të zbatimit duhet të jenë të shprehura në euro.

2. Shtetet anëtare monedha e të cilave nuk është euro në datën e kërkesës për pagesë, i konvertojnë në euro shumat e shpenzimeve të bëra në monedhën vendase. Këto shuma konvertohen në euro duke përdorur kursin mujor të këmbimit kontabël të Komisionit në muajin gjatë të cilit shpenzimet janë regjistruar në llogaritë e autoritetit përgjegjës të programit kombëtar në fjalë. Kursi i këmbimit publikohet çdo muaj në mënyrë elektronike nga Komisioni.



3. Në rastet kur euroja bëhet monedha e një shteti anëtar, procedura e konvertimit e përcaktuar në paragrafin 2 vazhdon të zbatohet për të gjitha shpenzimet e regjistruara në llogari nga autoriteti përgjegjës, para datës së hyrjes në fuqi të normës fikse të konvertimit ndërmjet monedhës kombëtare dhe euros.

## SEKSIONI 4

### LIKUIDIMI I LLOGARIVE DHE KORRIGJIMET FINANCIARE

#### Neni 44

#### **Kërkesa për pagesën e bilancit vjetor**

1. Deri më 15 shkurt të vitit në vijim të vitit financiar, secili shtet anëtar i dorëzon Komisionit dokumentet dhe informacionet e kërkuara sipas nenit 59, paragrafi 5 të Rregullores (BE, Euratom) nr. 966/2012. Dokumentet e paraqitura shërbejnë si kërkesë për pagesën e bilancit vjetor. Në raste të jashtëzakonshme, pas një komunikate nga shteti anëtar i interesuar, Komisioni mund ta shtyjë afatin e 15 shkurtit maksimumi deri më 1 mars. Shtetet anëtare mund ta publikojnë atë informacion deri në një masë të përshtatshme.

2. Komisioni mund të kërkojë nga një shtet anëtar që të japë informacione të mëtejshme me qëllim likuidimin vjetor të llogarive. Nëse një shtet anëtar nuk ofron informacionin e kërkuar deri në afatin e fundit për paraqitjen e tij të përcaktuar nga Komisioni, Komisioni mund të marrë vendimin e tij për likuidimin e llogarive në bazë të informacionit që zotëron.

3. Komisioni miraton, nëpërmjet akteve zbatuese, modelet sipas të cilave hartohen dokumentet e përmendura në paragrafin 1. Këto akte zbatuese miratohen në përputhje me procedurën këshillimore të përmendur në nenin 59, paragrafi 2.

#### Neni 45

#### **Likuidimi vjetor i llogarive**

1. Deri më 31 maj të vitit që pason vitin financiar, Komisioni vendos për likuidimin e llogarive vjetore për çdo program kombëtar. Vendimi për likuidimin mbulon plotësinë, saktësinë dhe vërtetësinë e llogarive vjetore të paraqitura dhe nuk cenon ndonjë korrigjim financiar të mëvonshëm.

2. Nëpërmjet akteve zbatuese, Komisioni përcakton masat për zbatimin e procedurës vjetore të likuidimit të llogarive, për sa i përket masave që duhet të ndërmerren në lidhje me miratimin e vendimit dhe zbatimin e tij, duke përfshirë shkëmbimin e informacionit midis Komisionit dhe shteteve anëtare dhe afatet që duhet të respektohen. Këto akte zbatuese miratohen në përputhje me procedurën e shqyrtimit të përmendur në nenin 59, paragrafi 3.

#### Neni 46

#### **Korrigjimet financiare nga shtetet anëtare**

Shtetet anëtare kryejnë korrigjimet financiare të kërkuara në lidhje me parregullsitë individuale ose të sistemit, të zbuluara në programet kombëtare. Korrigjimet financiare konsistojnë në anulimin e të gjithë ose një pjese të kontributit nga buxheti i BE-së në fjalë. Shtetet anëtare marrin parasysh natyrën dhe rëndësinë e parregullsive dhe humbjen financiare në buxhetin e BE-së dhe zbatojnë një korrigjim proporcional. Shumat e anuluar dhe shumat e rikuperuara, si dhe interesi mbi to, do të rialokohen në programin kombëtar në fjalë, duke përjashtuar shumat që rezultojnë nga parregullsitë e identifikuar nga Gjykata e Audituesve dhe shërbimet e Komisionit, duke përfshirë OLAF-in. Pas mbylljes së programit kombëtar, shteti anëtar në fjalë rimbursion shumat e rikuperuara në buxhetin e BE-së.

Neni 47

### **Likuidimi i përshtatshmërisë dhe korrigjimet financiare të Komisionit**

1. Komisioni kryen korrigjime financiare duke anuluar të gjithë ose një pjesë të kontributit të BE-së në një program kombëtar dhe duke bërë rikuperimin nga shteti anëtar në fjalë, për të përjashtuar nga financimi i BE-së çdo shpenzim që është në kundërshtim me ligjin në fuqi, duke përfshirë edhe mangësitë në sistemet e menaxhimit dhe kontrollit të shteteve anëtare, të cilat janë zbuluar nga Komisioni ose Gjykata e Audituesve.

2. Shkelja e ligjit në fuqi çon në një korrigjim financiar vetëm në lidhje me shpenzimet që i janë deklaruar Komisionit dhe kur plotësohet një nga kushtet e mëposhtme:

a) shkelja ka ndikuar në përzgjedhjen e një projekti në kuadrin e programit kombëtar ose, në rastet kur për shkak të natyrës së shkeljes nuk është e mundur të përcaktohet ky ndikim, ekziston një rrezik i vërtetuar që shkelja ka pasur një efekt të tillë;

b) shkelja ka ndikuar në shumën e shpenzimeve të deklaruara për rimbursim nga buxheti i BE-së, ose në rastet kur, për shkak të natyrës së shkeljes, nuk është e mundur të përcaktohet ndikimi i saj financiar, por ekziston një rrezik i vërtetuar që shkelja ka pasur një efekt të tillë.

3. Kur vendoset për një korrigjim financiar sipas paragrafit 1, Komisioni respekton parimin e proporcionalitetit duke marrë parasysh natyrën dhe rëndësinë e shkeljes së ligjit në fuqi dhe implikimeve të tij financiare për buxhetin e BE-së.

4. Para miratimit të ndonjë vendimi për refuzimin e financimit, gjetjet e Komisionit dhe përgjigjet e shtetit anëtar njoftohen me shkrim dhe në vijim të dy palët do të përpiqen të arrijnë një marrëveshje për veprimin që duhet ndërmarrë.

5. Financimi mund të mos refuzohet për:

a) shpenzimet që janë shkaktuar nga autoriteti përgjegjës për më shumë se 36 muaj para se Komisioni ta njoftojë shtetin anëtar me shkrim për gjetjet e tij;

b) shpenzimet për veprime shumëvjeçare brenda fushës së zbatimit të programeve kombëtare, kur detyrimi përfundimtar ndaj përfituesit ndodh më shumë se 36 muaj para se Komisioni ta njoftojë shtetin anëtar me shkrim për gjetjet e tij;

c) shpenzimet për veprimet në programet kombëtare, përveç atyre të përmendura në germën "b", për të cilat pagesa ose, sipas rastit, pagesa përfundimtare, nga autoriteti përgjegjës, kryhet më shumë se 36 muaj para se Komisioni të njoftojë shtetet anëtare me shkrim për gjetjet e tij.

6. Nëpërmjet akteve zbatuese, Komisioni përcakton masat për zbatimin e verifikimit të përshtatshmërisë në lidhje me masat që duhet të ndërmerren në lidhje me miratimin e vendimit dhe zbatimin e tij, duke përfshirë shkëmbimin e informacionit ndërmjet Komisionit dhe shteteve anëtare dhe afatet që duhet të respektohen. Këto akte zbatuese miratohen në përputhje me procedurën e shqyrtimit të përmendur në nenin 59, paragrafi 3.

Neni 48

### **Detyrimet e shteteve anëtare**

Një korigjim financiar nga Komisioni nuk cenon detyrimin e shtetit anëtar për të ndjekur rikuperimet sipas germës "h" të nenit 21 të kësaj rregulloreje dhe për të rimarrë ndihmën shtetërore në kuptim të nenit 107, paragrafi 1 të TFBE-së dhe nenit 14 të Rregullores së Këshillit (KE) nr. 659/1999<sup>12</sup>.

Neni 49

### **Rimbursimi**

1. Çdo rimbursim ndaj buxhetit të BE-së kryhet përpara datës së caktuar për pagesën që tregohet në urdhrin për rikuperim të hartuar në përputhje me nenin 80 të Rregullores (BE, Euroatom) nr. 966/2012. Ajo datë e përcaktuar është dita e fundit e muajit të dytë pas nxjerrjes së urdhrin.

2. Çdo vonesë në kryerjen e rimbursimit çon në kamatëvonesa, duke filluar nga data e caktuar e pagesës dhe duke përfunduar në datën e pagesës aktuale. Norma e kësaj kamatëvonese është 1,5 për qind më shumë se norma e zbatuar nga Banka Qendrore Evropiane në operacionet e saj kryesore të rifinancimit në ditën e parë të punës të muajit në të cilin bie data e caktuar e pagesës.

## **SEKSIONI 5**

### **ANULIMI I FINANCIMIT**

Neni 50

### **Parimet**

1. Programet kombëtare i nënshtrohen një procedure anulimi sipas së cilës shumat e lidhura me një angazhim të cilat nuk mbulohen nga financimi paraprak fillestar dhe vjetor i përmendur në nenin 35 dhe një kërkesë për pagesë në përputhje me nenin 44 deri më 31 dhjetor të vitit të dytë pas atij të angazhimit buxhetor, anulohen. Për qëllimin e anulimit të financimit,

Komisioni e llogarit shumën duke i shtuar një të gjashtë e angazhimit buxhetor vjetor në lidhje me kontributin e përgjithshëm të vitit 2014 secilit prej angazhimeve buxhetore 2015-20.

2. Duke deroguar nga paragrafi 1, afatet për anulimin nuk zbatohen për angazhimin buxhetor vjetor që lidhet me kontributin vjetor të vitit 2014.

3. Nëse angazhimi i parë vjetor i buxhetit lidhet me kontributin e përgjithshëm vjetor të vitit 2015, duke deroguar nga paragrafi 1, afatet për anulimin nuk zbatohen për angazhimin buxhetor vjetor që lidhet me kontributin vjetor të përgjithshëm të vitit 2015. Në këto raste, Komisioni e llogarit shumën sipas paragrafit 1, duke i shtuar një të gjashtë e angazhimit buxhetor vjetor që lidhet me kontributin e përgjithshëm të vitit 2015 secilit prej angazhimeve buxhetore të 2016-20.

4. Angazhimi që lidhet me vitin e fundit të periudhës anulohet në përputhje me rregullat e ndjekura për mbylljen e programeve.

5. Çdo angazhim ende i hapur në datën e fundit kur shpenzimet mund të jenë të pranueshme, siç përmendet në nenin 17, paragrafi 3 dhe për të cilin nuk është bërë kërkesë pagese nga autoriteti përgjegjës brenda gjashtë muajve pas kësaj date, anulohet automatikisht.

Neni 51

### **Përfundime për anulimin**

1. Nga shuma e përfshirë nga anulimi zbriten shumat që autoriteti përgjegjës nuk ka qenë në gjendje t'ia deklarojë Komisionit për shkak të:

a) veprimeve të pezulluara nga procedime ligjore ose nga një ankesë administrative që ka efekt pezullues; ose

b) arsyes së një force madhore që prek seriozisht zbatimin e gjithë apo një pjese të programit kombëtar. Autoritetet përgjegjëse që kanë pretendime për forcë madhore paraqesin pasojat e drejtpërdrejta të forcës madhore në zbatimin e të gjithë ose një pjese të programit kombëtar.

Zbritja mund të kërkohet një herë nëse pezullimi ose forca madhore kanë zgjatur deri në një vit. Nëse pezullimi ose forca madhore kanë zgjatur më shumë se një vit, zbritja mund të kërkohet disa herë, sipas kohëzgjatjes së forcës madhore ose të numrit të viteve midis datës së vendimit ligjor ose administrativ që pezullon zbatimin e veprimit dhe datës së vendimit ligjor ose administrativ të formës së prerë.

2. Shteti anëtar i dërgon Komisionit informacion për përfundimet që përmenden në paragrafin 1 deri më 31 janar, me qëllim që shuma të deklarohet deri në fund të vitit paraardhës.

3. Pjesa e angazhimeve buxhetore për të cilat është bërë një kërkesë për pagesë, por pagesa e të cilave është reduktuar ose pezulluar nga Komisioni më 31 dhjetor të vitit N + 2, nuk merret parasysh në llogaritjen e anulimit automatik.

## Neni 52

### **Procedura**

1. Komisioni informon shtetet anëtare sa më shpejt që të jetë e mundur kurdo që ekziston rreziku i zbatimit të anulimit sipas nenit 50.
2. Në bazë të informacionit që zotëron në 31 janar, Komisioni informon autoritetin përgjegjës për shumën e anulimit që rezulton nga ai informacion.
3. Shteti anëtar në fjalë ka dy muaj kohë për të rënë dakord për shumën që do të anulohet apo për të dorëzuar komentet e tij.
4. Komisioni kryen anulimin automatik jo më vonë se nëntë muaj pas afatit të fundit që rezulton nga zbatimi i paragrafëve 1 deri në 3.
5. Në rast të anulimit automatik, nga kontributi nga buxheti i BE-së për programin kombëtar përkatës zbritet, për vitin në fjalë, shumën e anuluar automatikisht. Kontributi i BE-së në planin financiar do të reduktohet pro rata, në rast se shteti anëtar nuk harton një plan financiar të rishikuar.

## KREU V

### INFORMACIONI, KOMUNIKIMI, MONITORIMI, VLERËSIMI DHE RAPORTIMI

## Neni 53

### **Informimi dhe publikimi**

1. Shtetet anëtare dhe autoritetet përgjegjëse janë përgjegjëse për:
  - a) një faqe interneti ose një portal interneti që jep informacion për dhe akses në programet kombëtare në atë shtet anëtar;
  - b) informimin e përfituesve të mundshëm mbi mundësitë e financimit në zbatim të programeve kombëtare;
  - c) publikimin e rolit dhe arritjeve të rregulloreve specifike për qytetarët e BE-së, nëpërmjet veprimeve të informimit dhe komunikimit për rezultatet dhe ndikimin e programeve kombëtare.
2. Shtetet anëtare garantojnë transparencë në zbatimin e planeve kombëtare dhe mbajnë një listë veprimesh që mbështeten nga çdo program kombëtar, e cila aksesohet nëpërmjet faqes së internetit ose portalit të internetit. Lista e veprimeve përfshin informacion të përditësuar për përfituesit përfundimtarë, emrat e projekteve dhe shumën që u alokohet atyre nga fondi i BE-së.
3. Si rregull, informacioni bëhet publik, përveç rasteve kur ai është i ndaluar për shkak të natyrës konfidenciale, veçanërisht në lidhje me sigurinë, rendin publik, hetimet penale dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

4. Komisioni autorizohet të miratojë aktet e deleguara në përputhje me nenin 58 për të vendosur rregulla në lidhje me informacionin dhe masat e publikimit për publikun dhe masat informuese për përfituesit.

5. Nëpërmjet akteve zbatuese, Komisioni përcakton karakteristikat teknike të informacionit dhe masat e publikimit. Këto akte zbatuese miratohen nga Komisioni në përputhje me procedurën e shqyrtimit të përmendur në nenin 59, paragrafi 3.

#### Neni 54

### **Raportet për zbatimin**

1. Përpara 31 marsit 2016 dhe 31 marsit të çdo viti pasues deri në vitin 2022 duke përfshirë këtë të fundit, autoriteti përgjegjës i dorëzon Komisionit një raport vjetor për zbatimin e secilit program kombëtar në vitin financiar paraardhës dhe mundet, në nivelin e përshtatshëm, ta publikojë atë informacion. Raporti i dorëzuar në vitin 2016 mbulon vitet financiare 2014 dhe 2015. Përpara 31 dhjetorit 2023, shteti anëtar dorëzon një raport përfundimtar për zbatimin e programit kombëtar.

2. Raportet vjetore për zbatimin japin informacione për:

- a) zbatimin e programit kombëtar duke ju referuar të dhënave financiare dhe treguesve;
- b) çdo çështje të rëndësishme që ndikon në përmbushjen e programit kombëtar.

3. Në kuadër të rishikimit afatmesëm, siç përmendet në nenin 15, raporti vjetor për zbatimin i dorëzuar në 2017 paraqet dhe vlerëson:

- a) informacionin e përmendur në paragrafin 2;
- b) progresin e bërë për arritjen e objektivave në programet kombëtare, të cilat mbështeten me kontribut nga buxheti i BE-së;
- c) përfshirjen e partnerëve të rëndësishëm, siç përmendet në nenin 12.

4. Raporti vjetor për zbatimin i dorëzuar në 2020 dhe raporti përfundimtar për zbatimin, përveç informacionit dhe vlerësimit të përcaktuar në paragrafin 2, përfshijnë informacion për dhe vlerësojnë progresin e bërë për arritjen e objektivave të programit kombëtar, duke pasur parasysh rezultatet e dialogut të politikave të përmendur në nenin 13, paragrafi 1.

5. Raportet vjetore për zbatimin që përmenden në paragrafët 1 deri 4 pranohen nëse përmbajnë të gjithë informacionin e kërkuar nga ata paragrafë. Komisioni informon shtetin anëtar në fjalë brenda 15 ditësh pune nga data e marrjes së raportit vjetor të zbatimit nëse ai nuk është i pranueshëm, dhe nëse kjo nuk bëhet, ai cilësohet si i pranueshëm.

6. Komisioni informon shtetin anëtar në fjalë për komentet e tij mbi raportin vjetor të zbatimit brenda dy muajve nga data e marrjes së tij. Nëse Komisioni nuk jep komente brenda këtij afati, raportet konsiderohen të pranuar.

7. Komisioni mund të bëjë komente për problemet e vërejtura në raportin vjetor të zbatimit të autoritetit përgjegjës, të cilat ndikojnë në zbatimin e programit kombëtar. Aty ku bëhen këto komente, autoriteti përgjegjës siguron informacionin e nevojshëm në lidhje me ato komente dhe, sipas rastit, informon Komisionin për masat e marra. Komisioni informohet jo më vonë se tre muaj pasi ai ka bërë këto komente.

8. Nëpërmjet akteve zbatuese, Komisioni miraton modelet sipas të cilave hartohen raportet vjetore dhe përfundimtare për zbatimin. Këto akte zbatuese miratohen në përputhje me procedurën këshillimore të përmendur në nenin 59, paragrafi 2.

Neni 55

### **Kuadri i përbashkët i monitorimit dhe i vlerësimit**

1. Komisioni kryen monitorim të rregullt të kësaj rregulloreje dhe rregulloreve specifike, sipas rastit, në bashkëpunim me shtetet anëtare.

2. Zbatimi i rregulloreve specifike vlerësohet nga Komisioni në partneritet me shtetet anëtare në përputhje me nenin 57.

3. Krijohet një kuadër i përbashkët monitorimi dhe vlerësimi me qëllimin për të matur rëndësinë, efektivitetin, efikasitetin, vlerën e shtuar dhe qëndrueshmërinë e veprimeve dhe thjeshtësimin e reduktimin e barrës administrative, në kuadër të objektivave të kësaj rregulloreje dhe rregulloreve specifike dhe përmbushjes së kësaj rregulloreje dhe rregulloreve specifike si instrumente që kontribuojnë në zhvillimin e zonës së lirisë, sigurisë dhe drejtësisë.

4. Komisioni ka kompetencën të miratojë aktet e deleguara në përputhje me nenin 58 për të zhvilluar më tej kuadrin e përbashkët të monitorimit dhe vlerësimit.

5. Shtetet anëtare i sigurojnë Komisionit informacionin e nevojshëm që i mundësojnë monitorimin dhe vlerësimin e kësaj rregulloreje dhe rregulloreve specifike.

6. Komisioni merr parasysh gjithashtu faktin që veprimet e zbatuara sipas rregulloreve specifike dhe atyre të ndjekura sipas politikave, instrumenteve dhe iniciativave të tjera përkatëse të BE-së plotësojnë njëri-tjetrin.

7. Komisioni i kushton rëndësi të veçantë monitorimit dhe vlerësimit të veprimeve dhe programeve të lidhura me vendet e treta, në përputhje me nenin 8.

Neni 56

### **Vlerësimi i programeve kombëtare nga shtetet anëtare**

1. Shtetet anëtare kryejnë vlerësimet e përmendura në nenin 57, paragrafi 1. Vlerësimi që do të kryhet në vitin 2017 kontribuon në përmirësimin e cilësisë së hartimit dhe zbatimit të programeve kombëtare, në përputhje me kuadrin e përbashkët të monitorimit dhe vlerësimit.

2. Shtetet anëtare sigurohen që të kenë përcaktuar procedurat për të prodhuar dhe mbledhur të dhënat e nevojshme për vlerësimet e përmendura në paragrafin 1, përfshirë të dhënat e lidhura me treguesit në kuadrin e përbashkët të monitorimit dhe vlerësimit.

3. Vlerësimet e përmendura në nenin 57, paragrafi 1 kryhen nga ekspertë të cilët janë të pavarur nga ana funksionale nga autoritetet përgjegjëse, autoritetet e auditit dhe autoritetet e deleguara. Këta ekspertë mund të jenë të atashuar pranë një institucioni publik autonom përgjegjës për monitorimin, vlerësimin dhe auditimin e administratës. Komisioni jep udhëzime për mënyrën se si duhet të kryhen vlerësimet.

4. Vlerësimet e përmendura në nenin 57, paragrafi 1 bëhen tërësisht publike, përveç aty ku informacioni është i ndaluar për shkak të natyrës konfidenciale, veçanërisht në lidhje me sigurinë, rendin publik, hetimet penale dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

#### Neni 57

### **Raportet e vlerësimit nga shtetet anëtare dhe Komisioni**

1. Në përputhje me kuadrin e përbashkët të monitorimit dhe të vlerësimit, shtetet anëtare i dorëzojnë Komisionit:

a) një raport të përkohshëm vlerësimi për zbatimin e veprimeve dhe progresin e bërë për arritjen e objektivave të programeve të tyre kombëtare deri më 31 dhjetor 2017;

b) një raport të mëpasshëm vlerësimi mbi efektet e veprimeve në zbatim të programeve të tyre kombëtare deri më 31 dhjetor 2023.

2. Bazuar në raportet e përmendura në paragrafin 1, Komisioni i dorëzon Parlamentit Evropian, Këshillit, Komitetit Evropian Ekonomik dhe Social dhe Komitetit të Rajoneve:

a) një raport të përkohshëm vlerësimi për zbatimin e kësaj rregulloreje dhe rregulloreve specifike në nivelin e BE-së deri më 30 qershor 2018. Ai raport i përkohshëm vlerësimi përfshin një vlerësim të rishikimit afatmesëm të kryer në përputhje me këtë rregullore dhe rregulloret specifike;

b) një raport të mëpasshëm vlerësimi për efektet e kësaj rregulloreje dhe rregulloreve specifike, pas mbylljes së programeve kombëtare, deri më 30 qershor 2024.

3. Vlerësimi i mëpasshëm i Komisionit shqyrton gjithashtu ndikimin e rregulloreve specifike mbi zhvillimin e zonës së lirisë, sigurisë dhe drejtësisë për sa i përket kontributit të tyre ndaj objektivave të mëposhtme:

a) zhvillimi i një kulture të përbashkët për sigurinë e kufijve, bashkëpunimin për zbatimin e ligjit dhe menaxhimin e krizave;

b) menaxhimi i efektshëm i flukseve të migracionit në BE;

c) zhvillimi i sistemit të përbashkët evropian për azilin;



d) trajtimi i drejtë dhe i barabartë i shtetasve të vendeve të treta;

e) solidariteti dhe bashkëpunimi midis shteteve anëtare në trajtimin e migracionit dhe çështjeve të sigurisë së brendshme;

f) një qasje e përbashkët e BE-së ndaj vendeve të treta për migracionin dhe sigurinë.

4. Të gjitha raportet e vlerësimit në zbatim të këtij neni, publikohen të plota, përveç rasteve kur ky informacion është i ndaluar për shkak të natyrës konfidenciale, veçanërisht në lidhje me sigurinë, rendin publik, hetimet penale dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

## KREU VI

### DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

#### Neni 58

#### **Ushtrimi i delegimit**

1. Kompetencat për të miratuar aktet e deleguara i delegohen Komisionit sipas kushteve të përcaktuara në këtë nen.

2. Kompetenca për të miratuar aktet e deleguara të përmendura në nenin 5, paragrafi 5, nenin 29, paragrafi 1, nenin 53, paragrafi 4 dhe nenin 55, paragrafi 4 i delegohet Komisionit për një periudhë prej shtatë vjetësh, duke nisur nga data 21 maj 2014. Komisioni harton një raport në lidhje me delegimin e kompetencave jo më vonë se nëntë muaj përpara përfundimit të periudhës shtatë vjeçare. Delegimi i kompetencave shtyhet në heshtje për periudha me kohëzgjatje të njëjtë nëse Parlamenti Evropian ose Këshilli nuk e kundërshton këtë shtyrje jo më vonë se tre muaj përpara përfundimit të periudhës shtatë vjeçare.

3. Delegimi i kompetencave të përcaktuara në nenet 5, paragrafi 5, 26, paragrafi 4, 29, paragrafi 1, 53, paragrafi 4 dhe nenin 55, paragrafi 4, mund të revokohet në çdo kohë nga Parlamenti Evropian ose nga Këshilli. Vendimi i revokimit i jep fund delegimit të kompetencave të specifikuar në atë vendim. Ai hyn në fuqi një ditë pas botimit të vendimit në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian ose në një datë të mëvonshme që specifikohet në vendim. Ai nuk cenon vlefshmërinë e ndonjë akti të deleguar të hyrë tashmë në fuqi.

4. Kur miraton një akt të deleguar, Komisioni njofton për këtë njëkohësisht Parlamentin Evropian dhe Këshillin.

5. Një akt i deleguar, i miratuar sipas nenit 5, paragrafi 5, nenit 26, paragrafi 4, nenit 29, paragrafi 1, nenit 53, paragrafi 4 dhe nenit 55, paragrafi 4, hyn në fuqi vetëm nëse nuk është shprehur asnjë kundërshtim as nga Parlamenti Evropian, as nga Këshilli, brenda një periudhe dy mujore pasi Parlamenti Evropian ose Këshilli është njoftuar për këtë akt, ose nëse, përpara përfundimit të kësaj periudhe, Parlamenti Evropian dhe Këshilli kanë informuar Komisionin se nuk do të kundërshtojnë. Kjo periudhë shtyhet me dy muaj me nismën e Parlamentit Evropian ose të Këshillit.

Neni 59

### **Procedura e Komitetit**

1. Komisioni asistohet nga Komiteti i Fondeve për Azilin, Migracionin dhe Integrimin e Sigurinë e Brendshme. Ky Komitet është një komitet sipas kuptimit të Rregullores (BE) nr. 182/2011.

2. Aty ku përmendet ky paragraf, gjen zbatim neni 4 i Rregullores (BE) nr. 182/2011.

3. Aty ku përmendet ky paragraf, gjen zbatim neni 5 i Rregullores (BE) nr. 182/2011.

Kur komiteti nuk jep asnjë mendim, Komisioni nuk miraton draftin e aktit zbatues, përveç nenit 14, paragrafi 4, neni 24, paragrafi 5, neni 45, paragrafi 2, neni 47, paragrafi 6 dhe neni 53, paragrafi 5 të kësaj rregulloreje.

Neni 60

### **Rishikimi**

Me propozim të Komisionit, Parlamenti Evropian dhe Këshilli rishikojnë këtë rregullore përpara 30 qershorit 2020.

Neni 61

### **Hyrja në fuqi dhe zbatimi**

Kjo rregullore hyn në fuqi një ditë pas botimit të saj në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Zbatimi i saj fillon nga data 1 janar 2014.

Kjo rregullore është detyruese në tërësinë e saj dhe drejtpërdrejt e zbatueshme në të gjitha shtetet anëtare, në përputhje me traktatet.

Nënshkruar në Strasburg, më 16 prill 2014.

Për Parlamentin Evropian

Presidenti

M. SCHULZ

Për Këshillin

Presidenti

D. KOURKOULAS

- 
- <sup>1</sup>. *Gazeta Zyrtare C 299, 4.10.2012, f. 108.*
  - <sup>2</sup>. *Gazeta Zyrtare C 277, 13.9.2012, f. 23.*
  - <sup>3</sup>. Qëndrimi i Parlamentit Evropian i 13 marsit 2014 (ende i pabotuar në Gazetën Zyrtare) dhe Vendimi i Këshillit i 14 prillit 2014.
  - <sup>4</sup>. Rregullorja (BE, Euratom) nr. 966/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 25 tetor 2012, "Për rregullat financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Evropian dhe që shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KE, Euratom) nr. 1605/2002" (*Gazeta Zyrtare L 298, 26.10.2012, f. 1*).
  - <sup>5</sup>. Vendim i Komisionit 1999/352/KE, KEQC, Euratom i 28 prillit 1999 "Për krijimin e Zyrës Evropiane Kundër Mashtrimit" (OLAF) (*Gazeta Zyrtare L 136, 31.5.1999, f. 20*).
  - <sup>6</sup>. Rregullorja (BE) nr. 182/2011 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 16 shkurtit 2011 që përcakton rregullat dhe parimet e përgjithshme për mekanizmat e kontrollit nga shtetet anëtare për ushtrimin e kompetencave zbatuese nga Komisioni (*Gazeta Zyrtare L 55, 28.2.2011, f. 13*).
  - <sup>7</sup>. Rregullorja e Këshillit (BE, Euratom) nr. 1311/2013, e 2 dhjetorit 2013, "Për përcaktimin e kuadrit financiar shumëvjeçar për periudhën 2014-2020" (*Gazeta Zyrtare L 347, 20.12.2013, f. 884*).
  - <sup>8</sup>. Rregullorja (BE) nr. 516/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 16 prillit 2014 "Për përcaktimin e fondit për Azilin, Migracionin dhe Integrimin", që ndryshon Vendimin e Këshillit 2008/381/KE dhe shfuqizon Vendimet nr. 573/2007/KE dhe nr. 575/2007/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe Vendimin e Këshillit 2007/435/KE (shihni faqen 168 të kësaj gazete Zyrtare).
  - <sup>9</sup>. Rregullorja (BE) nr. 513/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 16 prillit 2014 që vendosi, si pjesë e Fondit të Sigurisë së Brendshme, instrumentin për mbështetjen financiare për bashkëpunimin policor, parandalimin dhe luftën ndaj krimit dhe menaxhimin e krizës që shfuqizon Vendimin e Këshillit 2007/125/ÇBD (shihni faqen 93 të kësaj Gazete Zyrtare).
  - <sup>10</sup>. Rregullorja (BE, Euratom) nr. 883/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 11 shtator 2013, "Për hetimet e kryera nga Zyra Evropiane kundër Mashtrimit (OLAF)" dhe që shfuqizon Rregulloren (KE) nr. 1073/1999 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe Rregulloren e Këshillit (Euratom) nr. 1074/1999 (*Gazeta Zyrtare L 248, 18.9.2013, f. 1*).
  - <sup>11</sup>. Rregullorja e Këshillit (Euratom, KE) nr. 2185/96, e 11 nëntorit 1996, "Për kontrollet dhe inspektimet në terren të kryera nga Komisioni për mbrojtjen e interesave financiare të Komuniteteve Evropiane nga mashtrimi dhe parregullsi të tjera" (*Gazeta Zyrtare L 292, 15.11.1996, f. 2*).
  - <sup>12</sup>. Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 659/1999, e 22 marsit 1999, "Për përcaktimin e rregullave për zbatimin e nenit 108 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian" (*Gazeta Zyrtare L 83, 27.3.1999, f. 1*).
-